

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6783
E premte, 15 dhjetor 2022
çmimi 0.40 €

Dita e gjashtë
e barrikadave, situatë
e qetë në veri | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FATMIR LIMAJ VIZITON LIDERËT E UÇK-SË NË HAGË | FAQE 4-5

BETEJA E THAÇIT, KRASNIQIT, VESELIT DHE SELIMIT ËSHTË PËR PAVARËSINË E KOSOVËS



Ish-anëtari i shtabit të përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Fatmir Limaj, ka vizituar të enjten liderët e UÇK-së, të cilët janë duke u mbajtur në qendrën e

paraburgimit të Gjykatës Speciale në Hagë. Para se të takohet me ta, Limaj ka thënë se beteja e Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe të tjerëve

nuk është personale, por beteje për Kosovën. Limaj ka thënë se edhe liderët e UÇK-së janë të vetëdijshëm se beteja e tyre është duke u zhvilluar për historinë e Kosovës

AKTUALE




REAGIM I KMDLNJ-së: GJYKATA SPECIALE, INSTRUMENT I DHUNËS I BORRELLIT KUNDËR KOSOVËS | F.7

FSK-ja HAP KONKURS PËR PRANIMIN E 612 USHTARËVE TË RINJ | F.7

GJERMANIA DO TË BLEJË AVIONË LUFTARAKË TË PRODHIMIT AMERIKAN | F.2

EKONOMI



MBAHET SESION INFORMUES ME BIZNESET E DIASPORËS | F.8

KUVENDI NUK E DYFISHON BUXHETIN PËR RRUGËN PRISHTINË - PODUJEVË | F.8

SPORT



ARGJENTINË - FRANCË, NJIHUNI ME SHIFRAT E DY FINALISTËVE | F.10



KURTI DORËZON APLIKIMIN E KOSOVËS PËR ANËTARËSIM NË BE | FAQE 3

OSMANI NUK VLERËSOHET PRESIDENTE UNIFIKUESE, PDK-ja DHE AAK-ja E BOJKOTOJNË FJALIMIN E SAJ VJETOR NË KUVENDIN | FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjermania do të blejë avionë luftarakë të prodhimit amerikan

BERLIN, 15 DHJETOR - Gjermania i ka dhënë dritën e gjelbër blerjes së dhjetëra avionëve luftarakë F-35 të prodhimit amerikan. Këto blerje do të jenë pjesë e rindërtimit të ushtrisë, proces që është nxitur nga pushtimi rus i Ukrainës.

Komiteti për buxhet i Parlamentit gjerman miratoi tetë projekte në vlerë të përgjithshme prej 13 miliardë eurosh, përfshirë edhe blerjen e avionëve luftarakë F-35, që është paraparë të kushtojnë 10 miliardë euro.

Për shkak të sfidave aktuale të sigurisë, përfshirë luftën e Rusisë kundër Ukrainës, bashkëpunimi i ngushtë në mes aleatëve është më i rëndësishëm

se kurrë, tha Ambasada amerikane në Berlin, pas vendimit të autoriteteve gjermane. "Programi gjerman i avionëve F-35 do të sigurojë vazhdimin e angazhimeve të Gjermanisë dhe do të garantojë mbrojtje më të fortë të NATO-s në të ardhmen", ka njoftuar Ambasada amerikane.

Ambasadorja Amy Gutmann shkroi në "Twitter" se partneriteti i mbrojtjes mes SHBA-së dhe Gjermanisë kurrë nuk ka qenë më i fortë. Ajo tha se ky partneritet është shtyllë kyçe e partneritetit transatlantik të NATO-s.

Të 35 avionët luftarakë pritet që të dorëzohen në Gjermani mes viteve 2026 dhe 2029, tha



Ambasada amerikane. Në mars, Berlini kishte njoftuar se dëshiron të blejë avionët amerikanë, për të zëvendësuar flotën e saj të Tornadove, që janë

avionë më të vjetër. Por, Ministria e Mbrojtjes kishte ngritur shqetësime për këtë plan, duke paralajmëruar se mund të kishte "vonesa dhe

kosto shtesë".

Kancelari gjerman, Olaf Scholz, ka thënë se lufta në Ukrainë e ka shtyrë Gjermaninë që ta bëjë këtë investim, që është investimi më i madh në ushtri që nga themelimi i saj pas Luftës së Dytë Botërore.

Komiteti parlamentar për buxhet po ashtu miratoi edhe blerjen e pushkëve të reja dhe radio-sistemeve.

Kancelari Scholz, disa ditë pas nisjes së pushtimit rus të Ukrainës në shkurt, kishte njoftuar se do të ndante 100 miliardë euro fonde për rindërtimin e ushtrisë. Paratë për blerjen e avionëve amerikanë do të merren nga ky fond.

ShBA-ja goditet nga një stuhi e fuqishme dimërore



Uashington, 15 dhjetor - Të paktën tre persona kanë vdekur pasi një stuhi e fuqishme dimërore po lëvizë në lindje përgjatë Shteteve të Bashkuara, duke shkaktuar tornado në shtetet jugore dhe duke mbuluar me borë pjesën tjetër të vendit.

Një djalë 8 vjeç, dhe nëna e tij 30-vjeçare, vdiqën në Luiziana, pasi shtëpia e tyre u shkatërrua nga një tornado. Po ashtu, një grua 54-vjeçare vdiq në këtë shtet për shkak të shkatërrimit të shtëpisë së saj nga tornadoja.

Stuhi të mëdha kanë goditur edhe pjesën qendrore të SHBA-së, duke shkaktuar mbyllje të rrugëve

dhe shkollave, pasi shumë shtete kanë raportuar se bora ka arritur në lartësi deri në 1.2 metra.

Rreth 3.300 fluturime janë shtyrë dhe mbi 150 janë anuluar.

Afër 500.000 persona në katër shtete - Nebraska, Uajomi, Dakota e Jugut dhe Minesota janë paralajmëruar se do të përballen me stuhi bore, teksa erërat e fuqishme dhe reshjet e borës kanë vështirësuar udhëtimin. Miliona banorë të tjerë në mbarë SHBA-në po ashtu janë goditur me stuhi të fuqishme bore.

Po ashtu, stuhi të fuqishme janë paraparë se do të godasin

Luizianën, Misisipin, Alabamën dhe pjesë të Floridës.

Të paktën 18 tornado kanë goditur Teksasin, Luizianën, Oklahomën dhe Misisipin, duke shkaktuar dëme materiale.

Për shkak të motit të keq, autoritetet në Luiziana kanë shpallur gjendje të jashtëzakonshme.

Shumica e shteteve në SHBA do të ndjejnë ndikimin e stuhive, pasi parashikohet se temperaturat e ulëta dhe reshjet e borës do të vazhdojnë në ditët në vijim.

Përveç shteteve amerikane, edhe Kanadaja është përballur me stuhi bore dhe erëra të fuqishme.

Mali i Zi në qorrsoçak, thonë Uashingtoni, Londra dhe Berlini

Podgoricë, 15 dhjetor - Mali i Zi duhet të zgjidhë ngërçin politik dhe të mbetet i përkushtuar në rrugën euroatlantike, tha i dërguari amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, pas takimit që pati me kryeministrin në mandat teknik, Dritan Abazović.

Ai i bëri thirrje Podgoricës që "të kundërshtojë qartë agresionin brutal të Rusisë kundër Ukrainës".

Në vizitë zyrtare në Mal të Zi po qëndrojnë edhe të dërguarit special të qeverive të Britanisë së Madhe dhe Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Stuart Pich dhe Manuel Sarazin.

Ata shprehën shqetësimin për krizën politike, bllokimin e institucioneve, polarizimin në rritje të shoqërisë dhe pafuqinë e vendimmarrësve për të gjetur një rrugëdalje nga kriza. "Vendimmarrësit duhet të konsiderojnë me kujdes mesazhin

e dëmshëm që do t'u dërgojnë partnerëve euroatlantikë nëse zgjedhin një kryeministër dhe formojnë një Qeveri bazuar në një Ligj që është i diskutueshëm nëse është në përputhje me Kushtetutën", thanë ata.

Aktualisht Gjykata Kushtetuese, e cila vlerëson nëse ligjet e miratuara janë në përputhje me të, nuk ka kuorum për vendimmarrje që nga shtatori.

Me iniciativën e Frontit Demokratik pro-rus, më 12 dhjetor shumica parlamentare miratoi amendamentet në Ligjin për Presidentin.

Me miratimin e këtij Ligji, kjo shumicë do të marrë një pjesë të kompetencave së presidentit Milo Gjukanović në zgjedhjen e Qeverisë së re.

Të dërguarit nga Britania dhe Gjermania shprehën shqetësimin e tyre për miratimin e

ndryshimeve, duke mos marrë parasysh rekomandimin kundër të Komisionit të Venecias. "Vendimet e marra në Kuvend më 12 dhjetor e përkeqësuan edhe më shumë krizën. Kjo është shumë shqetësuese dhe e dëmshme për Malin e Zi dhe qytetarët e tij", thanë të dërguarit special.

Qëllimi i ndryshimeve të propozuara nga Fronti Demokratik pro-rus është që kandidati i tyre, Miodrag Llekqi, të jetë kandidat për kryeministër i Qeverisë së re malazeze.

Opozita, e udhëhequr nga partia e Gjukanovićit, kërkon shpërndarjen e Parlamentit dhe organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme, por shumica parlamentare kërkon që të formohet një Qeveri e re që do të udhëhiqej nga Llekqi dhe zgjedhjet e rregullta të mbahen në vitin 2024.

Më 12 dhjetor, Komisioni Evropian



u bëri thirrje vendimmarrësve që ta tërheqin këtë Ligj, duke shprehur frikën se ky veprim do ta zhytë Malin e Zi në kaos kushtetues.

Që nga gushti i vitit 2020 në Mal të Zi kanë rënë dy qeveri, e fundit e Dritan Abazovićit në gusht të këtij viti.

FATMIR LIMAJ VIZITON LIDERËT E UÇK-SË NË HAGË

Beteja e Thaçit, Krasniqit, Veselit dhe Selimit është për pavarësinë e Kosovës

Ish-anëtari i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Fatmir Limaj, ka vizituar të enjten liderët e UÇK-së, të cilët janë duke u mbajtur në qendrën e paraburgimit të Gjykatës Speciale në Hagë. Para se të takohet me ta, Limaj ka thënë se beteja e Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe të tjerëve nuk është personale, por betejë për Kosovën. Limaj ka thënë se edhe liderët e UÇK-së janë të vetëdijshëm se beteja e tyre është duke u zhvilluar për historinë e Kosovës

“Epoka e re”

HAGË, 15 DHJETOR - Lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka vizituar të enjten bashkëluftëtarët e tij në Hagë, Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin, të cilët janë duke u mbajtur në Qendrën e Paraburgimit në Gjykatën Speciale. Vizitën e tij në Hagë, Limaj e ka përshkruar emocionuese, pasi po ndodh 17 vjet pas lirim të tij nga Tribunali i Hagës. “Emocion i veçantë që pikërisht në 17-vjetorin e lirim tim nga Tribunali i Hagës, t’i vizitoj bashkëluftëtarët e mi që ndodhen në objektin pas meje. Asnjëherë nuk e kam menduar që do të kthehem këtu për t’i vizituar krerët e UÇK-së, sepse kam qenë i bindur që jam luftëtar i fundit që futëm këtu dhe që dal nga kjo ndërtesë”, ka thënë Limaj.

Limaj ka thënë se Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe të tjerët nuk

janë në Hagë për çështje personale, por për Kosovën. Sipas tij, beteja e tyre është e fundit për pavarësinë e Kosovës. “Bashkëluftëtarët të cilët do t’i vizitoj sot e kanë të qartë që aty nuk janë për çështje personale, por për ta zhvilluar betejën e fundit për pavarësinë e Kosovës. Një betejë ndryshe, me mjete të tjera, me mjete ligjore!”, është shprehur Limaj, duke shtuar se bashkëluftëtarët e tij janë të vetëdijshëm për këtë betejë me Gjykatën Speciale. “Ata janë të vetëdijshëm që kjo betejë është për historinë e Kosovës. Pikërisht këtu po tentohet përmbysja e historisë së lavdishme të kombit tonë jo vetëm për ne që sot jetojmë, por për gjeneratat që do të vijnë edhe pas 100 vjetëve. Kështu që, beteja në Hagë nuk është betejë personale as e Hashim Thaçit, as e Jakup Krasniqit, as e Kadri Veselit, as e Rexhep Selimit dhe të tjerëve por, përmes tyre, është betejë për Kosovën! Lufta e UÇK-së ishte e drejtë, prandaj epilogu i kësaj betejë nuk mund të jetë ndryshe



pos fitore!”, ka thënë Limaj. Gjykata Speciale është krijuar mbi bazën e raportit të Dick Martyt, ku nga nëntori i vitit 2020 janë duke u mbajtur në paraburgim drejtuesit kryesorë të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi. Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi qysh në daljen e parë para trupit gjykes janë deklaruar të pafajshëm në lidhje me akuzat e prokurorisë. Edhe avokatët e liderëve të UÇK-së kanë kundërshtuar vazhdimisht akuzat ndaj klientëve të tyre. Ata kanë ofruar edhe argumente se si Zyra e Prokurorit të Specializuar në Speciale ka bashkëpunuar me

shërbimin inteligjent serb kundër liderëve të UÇK-së.

Kujtojmë se Kuvendi i Shqipërisë Kuvendi i Shqipërisë në korrik të këtij viti ka miratuar rezolutën e propozuar nga deputetët e PS-së kundër raportit të Dick Martyt. Kryeministri Edi Rama, kishte thënë se rezoluta është fillim i një rrugë që do të shkojë në Strasburg.

Në këtë kontekst më 13 tetor, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i është drejtuar Këshillit të Evropës për ta kërkuar rishikimin e raportit të Dick Martyt dhe për t’i shpallur të pabaza akuzat e tij për trafikim të organeve njerëzore gjatë luftës çlirimtare në Kosovë.

Gjatë fjalës së tij, Rama i ka hedhur poshtë të gjitha pretendimet e raportit duke i analizuar të gjitha pikat e tij. Ai ka thënë se ky raport është një fantazi e pastër e fabrikuar në Kremlin dhe i sjell në Këshillin e Evropës. “Ju bëj thirrje t’i rrëzoni akuzat kundër Kosovës. Ju bëj thirrje ta pranoni kërkesën e Shqipërisë që ta rrëzoni një rezolutë që degradon luftëtarët e Ushtrisë heroike Çlirimtare të Kosovës”, kishte thënë Rama.

Përpos Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit në qendrën e paraburgimit në Hagë janë edhe Salih Mustafa, Hysni Gucati, Nasim Haradinaj dhe Pjetër Shala.

Dita e gjashtë e barrikadave, situatë e qetë në veri

MITROVICË, 15 DHJETOR - Për të gjashtë ditë me radhë disa serbë në veri të Kosovës po vazhdojnë t’i bllokojnë rrugët që çojnë drejt pikave kufitare me Serbinë: Jarinjë dhe Bërnjak.

Vendosja e barrikadave nga disa serbë lokalë u nxit nga arrestimi i ish-pjesëtarit serb të Policisë së Kosovës, Dejan Pantiq. Kosova thotë se ai dyshohet për “sulm terrorist” ndaj zyrave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në veri më 6 dhjetor.

Situata në barrikada është e qetë. Shkollat fillore dhe të mesme, në veriun e banuar me shumicë serbe, e që funksionojnë sipas sistemit serb, janë të mbyllura që nga e hëna, sikurse edhe objektet e hotelierisë.

Shumica e qytetarëve që gjenden në barrikada janë punonjës të institucioneve serbe në Kosovë, nga sektori i shëndetësisë dhe arsimit. Siç mëson REL-i, ata dalin në barrikada me ndërtime.

Policia e Kosovës është vendosur në vendbanimet shumetnike në

Mitrovicë të Veriut: Lagjen e Boshnjakëve, Tre Rrokaqejt dhe në Kodrën e Minatorëve.

KFOR-i dhe EULEX-i po patrullojnë në Mitrovicë të Veriut, ndërkaj pjesëtarët e kontingjentit polak të KFOR-it gjenden në afërsi të barrikadës së ngritur në fshatin Rudar të Zveçanit. Kjo barrikadë gjendet në rrugën magjistrale Prishtinë - Leposaviq.

Pas vendosjes së barrikadave, serbët kanë formuar Shtabin e Krizave. Sipas nënkryetarit të Listës Serbe, Igor Simiq, në këtë shtab bëjnë pjesë “përfaqësuesit politikë të popullit serb, figura të shquara, profesorë, mjekë dhe biznesmenë”.

Disa serbë lokalë në veri të Kosovës qysh më 10 dhjetor kanë ngritur barrikada në rrugët që çojnë në dy pikat kufitare me Serbinë, Jarinjë dhe Bërnjak.

Kjo ka qenë përgjigja e tyre ndaj arrestimit të ish-policit serb, Dejan Pantiq, nga autoritetet e rendit në Kosovë. Atij më vonë i është shqiptuar masa e paraburgimit



prej një muaji.

Pantiq dyshohet se organizoi “sulm terrorist” në zyrat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në veri të Kosovës. I dërguari i Shteteve të Bashkuara për Ballkanin

Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë për “Radion Evropa e Lirë” se pret që barrikadat të hiqen nga personat që i kanë ngritur ato.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se pret që misioni

paqeruajtës i NATO-s, KFOR, t’i largojë barrikadat në veri. Autoritetet serbe kanë thënë se janë tronditur “me deklaratat e disa zyrtarëve evropianë që kanë bërë thirrje për largimin e barrikadave”.



Kurti dorëzon aplikimin e Kosovës për anëtarësim në BE

Kryeministri Albin Kurti ka dorëzuar të enjten aplikimin e Kosovës për anëtarësim në BE në Republikën Çeke, vendin që aktualisht kryeson Presidencën e BE-së. Ceremonia e dorëzimit është mbajtur në ndërtesën e Qeverisë Çeke në Pragë, ndërsa aplikimin Kurti ia ka dorëzuar ministrit për Çështje Evropiane të Çekisë, Mikulash Bek

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRAGË, 15 DHJETOR - Kosova të enjten ka dorëzuar aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka dorëzuar aplikimin në Republikën Çeke, vendin që aktualisht kryeson Presidencën e BE-së.

Ceremonia është mbajtur në ndërtesën e Qeverisë Çeke në Pragë, ndërsa aplikimin Kurti ia ka dorëzuar ministrit për Çështje Evropiane të Çekisë, Mikulash Bek.

Kryeministri Albin Kurti, në konferencën për medie para dorëzimit të aplikimit, e quajti "ditë të jashtëzakonshme për demokracinë në Evropë". "Kemi ardhur në Pragë për ta riafirmuar zotimin e pandryshueshëm të Kosovës ndaj vlerave themelore të BE-së, lirisë, demokracisë, të drejtave të njeriut, barazisë dhe sundimit të

ligjit duke dorëzuar aplikimin për anëtarësim", ka deklaruar Kurti.

Ai, gjithashtu, tha se është i vetëdijshëm që rruga për në BE bazohet në merita të shtetit. "Nuk kërkojmë derë anësore ose procedurë të shpejtë për hyrje në BE", ka thënë ai.

I pyetur në lidhje me pengesën që mund të paraqesin pesë shtetet e BE-së që nuk e njohin Kosovën, Kurti tha se kur Kosova e kishte nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, pesë shtetet ishin dakord. "Nuk besoj se pakica e shteteve anëtare të BE-së që ende nuk e njohin pavarësinë tonë do të jenë kundër bashkimit tonë në familjen evropiane", është shprehur Kurti.

Ndërkaq, ministri për Çështje Evropiane i Çekisë, Mikulash Bek, ka thënë se e mbështet Kosovën në rrugëtimin e saj drejt BE-së. "Vlerësojmë dhe çmujmë arritjet e Kosovës deri më tani. Ne po e plotësojmë një nga prioritetet e

Presidenti i Shqipërisë uron Kosovën për aplikimin për anëtarësim në BE

Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, ka thënë se dorëzimi i aplikimit të Kosovës për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian është një akt i rëndësishëm historik që i hap rrugë realizimit të aspiratës evropiane të saj. "Përgëzime autoriteteve të Kosovës dhe shumë suksese për përmbushjen e detyrimeve të procesit! U bëj thirrje të gjitha vendeve anëtare që ta mbështesin aplikimin e Kosovës, pasi kjo do të ishte jo vetëm në interesin më të mirë gjeopolitik të Bashkimit Evropian, por dhe një kontribut më shumë në mbështetje të një vendi e një populli me vokacion të qartë evropian dhe euro-atlantik. Urime Kosovë e shumë suksese!", ka shkruar Begaj në "Facebook".

Presidencës sonë (të BE-së), sepse në gjashtë muajt e fundit u kemi dhënë vëmendje të jashtëzakonshme çështjeve që kanë të bëjnë me Ballkanin Perëndimor", ka theksuar Bek. Pasi kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka dorëzuar aplikacionin në Pragë. Zyrtarët çekë, për shkak se aktualisht udhëheqin Presidencën e BE-së, do t'i informojnë 26 vendet e tjera anëtare për këtë vendim të Kosovës.

Diçka e tillë pritet të ndodhë javën e ardhshme në një takim që mbahet në nivel të ambasadorëve.

Mirëpo më pas do të jetë Suedia - e cila merr Presidencën e BE-së më 1 janar - që do të merret me këtë çështje. Kjo nënkupton nisje të konsultimeve me kryeqytetet e tjera të BE-së, sidomos ato mosnjohëse.

Ka indikacione që Këshilli do të marrë vendime se si të procedojë kur suedezët ta kenë Presidencën

e BE-së për dy arsye.

Së pari, sepse Spanja, ndoshta vendi më kundër pavarësisë së Kosovës, do të jetë në krye të BE-së pas Suedisë, dhe me shumë mundësi ajo nuk do të ketë dëshirë të merret me këtë punë.

Së dyti, më 2024 ka shumë mundësi që kjo çështje të fshihet nëpër sirtarë për shkak të zgjedhjeve që mbahen atë vit në Parlamentin Evropian dhe më pas zgjidhet edhe përbërja e re e Komisionit dhe Këshillit Evropian.

Një ditë më herët, udhëheqësit e Kosovës, përfshirë kryeministrin Kurti, presidenten Vjosa Osmani dhe kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca, e nënshkruan aplikimin në Prishtinë, duke e cilësuar këtë si "hap historik" për Kosovën.

Aplikimi i Kosovës përbën herën e parë që një shtet merr një nismë të tillë, pa u njohur zyrtarisht nga të gjitha vendet anëtare të BE-së. Në fakt ky është një rast ligjor sui generis me të cilin do të merret Brukseli.

Dhe nuk janë vetëm pesë shtetet mosnjohëse - Qiproja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Spanja që kanë mospajtimet e tyre. Vetë Bashkimi Evropian, si tërësi, nuk e njeh Kosovën si shtet sovran për shkak të pesësesh.

Osmani nuk vlerësohet presidente unifikuese, PDK-ja dhe AAK-e ja bojkotojnë fjalimin e saj vjetor në Kuvend

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës dhe grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e kanë bojkotuar fjalimin vjetor të presidentes Vjosa Osmani para deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Në këtë seancë nuk ishte i pranishëm kryeministri Albin Kurti, i cili ka udhëtuar për në Çeki për ta dorëzuar aplikimin e anëtarësimit të Kosovës për në BE. Presidentja Osmani në fjalimin e saj foli për situatën politike në vend dhe politikën e jashtme. Ajo ka thënë se veriu i Kosovës vazhdon të jetë sfidë për shkak të, siç tha, "pretendimeve territoriale të Serbisë".

Gjatë fjalimit vjetor para deputetëve të Kuvendit të Kosovës, Osmani sërish akuzoi Serbinë se mbështet "grupet kriminale" në veri të Kosovës. "Veriu i Kosovës vazhdon të jetë sfidë për shkak të pretendimeve

territoriale që Serbia ka ndaj Kosovës e të cilat i shpreh përmes financimit dhe përkrahjes së strukturave ilegale-kriminale. Por, ne jemi të vendosur si asnjëherë më parë që të krijojmë siguri e sundim të ligjit në çdo cep të territorit tonë", ka thënë Osmani.

Ajo u zotua se institucionet e Kosovës janë të vendosura për të ofruar siguri për qytetarët e Kosovës që jetojnë në këtë pjesë, teksa tha se "bandave kriminale" nuk po u pëlqen vendosmëria e institucioneve për sundim të ligjit. "Ata do të përballen me drejtësinë për veprat penale kundër rendit kushtetues dhe kërcënimit e frikësimit të qytetarëve", theksoi Osmani.

Presidentja e Kosovës e cilësoi si "ide hegjemoniste" paralajmërimin e Serbisë se do të kërkojë nga KFOR-i që t'i kthejë trupat serbe në Kosovë. "Jemi të gjithë dëshmitarë të kërcënimit të vazhdueshëm të Serbisë ndaj

Kosovës. Ky kërcënim, me përmasa agresioni, së fundi është shpërfaqur nëpërmjet idesë hegjemoniste të vendosjes së trupave ushtarake të Serbisë në Kosovë. Por, Serbia dhe udhëheqësi i saj [Aleksandar] Vuçiq, e dinë fare mirë se prania e ushtrisë serbe në territorin e Kosovës mori fund një herë e përgjithmonë më 12 qershor 1999", ka thënë Osmani.

Presidentja e Kosovës porositi se procesi i dialogut me Serbinë - që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian - duhet të përqendrohet në njohje të ndërsjellë që, sipas saj, do të ishte garanci për paqe të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Gjatë fjalimit prej 35-minutash, Osmani, po ashtu, foli për politikën e jashtme, duke thënë se në rrafshin diplomatik, shteti ka qenë aktiv. Ajo ka thënë se në Serbi dhe jashtë saj, ka njerëz që kjo gjë u pengon, duke theksuar se "më në fund Kosova ka politikë

të jashtme".

Osmani ka thënë se në Kosovë më nuk ka "lobim për ndryshim kufijsh" dhe "nuk ka flirtime me Serbinë dhe Rusinë me qëllim të interesave individuale". "Nuk ka udhëheqës që Kosovën e krahasojnë Nagrono-Karabak, Abkhazi e Krime. Koha e tregtarëve të kufijve ka përfunduar njëherë e përgjithmonë", ka deklaruar Osmani.

Grupi parlamentar i PDK-së konsideron se organizimi i fjalimit vjetor të presidentes Osmani para deputetëve të Kuvendit është një tjetër spektakël i pushtetit, që përmes rregullave formale të raportimit para Kuvendit, ta mbulojë dështimin e mospunës së presidentes. "Gjuha jounifikuese, tejet polarizuese dhe përçarëse e presidentes Osmani, apo heshtja kur e ka obligim të jetë në shërbim të çdo qytetari nga frika se mos nuk është në pajtim me

partnerin e saj politik, janë shembuj tipikë të një personi që nuk është kredibil ta ushtrojë detyrën shtetërore që aktualisht e gëzon.

Shembujt për këtë janë të shumtë, përfshirë edhe ato të ndërhyrjeve në punësime të familjarëve, shkarkimeve politike dhe mosmbështetjes së punonjësve në sektorin e arsimit, atë të shëndetësisë dhe shërbyesve civilë. Grupi parlamentar i PDK-së vlerëson se po të mos ishte prirja joparimore e këtij pushteti për të prodhuar performanca të tilla neveritëse, mbase këtë ngjarje ky pushtet ka qenë e udhës ta organizojë në zyrat e Vetëvendosjes përballë aktivistëve të kësaj partie e jo para të deputetëve të republikës. Për një vit, e para e shtetit ka qenë në shërbim të të parëve dhe kundër deputetëve të Republikës së Kosovës dhe jo vetëm", është thënë në njoftimin e PDK-së.



Shefi i EULEX-it: Patrulla jonë u sulmua në Rudar, aty kishte serbë të maskuar dhe të armatosur

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Situata e sigurisë, veçanërisht në veri të Kosovës, është shumë e tensionuar dhe do të ishte shumë keq nëse edhe serbët nga jugu do të largoheshin nga institucionet. Kështu ka thënë shefi i EULEX-it, Lars Gunnar Wigemark, në një intervistë për "Kosova Online", i cili ka ngritur shumë çështje, sidomos në aspektin e sigurisë. "Patrulla jonë u sulmua duke iu afruar barrikadave afër Rudarit në veri të Mitrovicës. Në këto barrikada kishte popullatë serbe,

por nuk mund të them 100 për qind siguri se kush e hodhi bombën trulllosëse. Falënderoj për deklaratat e presidentit Vuçiq dhe të tjerëve në të cilat kërkohet që EULEX-i dhe KFOR-i të mos sulmohen dhe se ne jemi këtu për ta përmbushur mandatin tonë", ka thënë ai.

Sipas Wigemark, EULEX-i së bashku me KFOR-in dhe Policinë e Kosovës po i përcjell me vëmendje zhvillimet. "Siç e dini, ka një sërë barrikadash në rrugë, veçanërisht në rrugën nga

Mitrovica për në Leposaviq, Jarinjë dhe më tej për në Serbi. Gjithashtu, ka edhe disa barrikada të tjera. Në përgjithësi mendoj se popullata vendese, qofshin ata serbë të Kosovës apo shqiptarë të Kosovës apo grupe të tjera etnike, por sigurisht që po flasim për serbët etnikë dominues që janë shumicë atje, janë shumë të shqetësuar. Njerëzit janë të frikësuar. Ka më shumë se një muaj që kur serbët janë larguar nga institucionet e Kosovës dhe ka një vakum sigurie", ka thënë ai.



Totaj vëzhgon nga afër projektet infrastrukturore

PRIZREN, 15 DHJETOR - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, së bashku me zyrtarë të komunës, vizituan të enjten lagjen "Arbana", ku panë nga afër asfaltimin e komplekseve

industriale - Rruga "Ramadan Thaqi", që do të shërbejë për banorët dhe bizneset e kësaj zone në qasjen më të shpejtë në akset rrugore të qytetit. "Projektet kapitale po

vazhdojnë, ku aktualisht në proces e sipër janë mbi 40 projekte infrastrukturore të cilat me intensitet të lartë do të vazhdojnë edhe gjatë vitit të ardhshëm", ka thënë Totaj.



Mbi 200 mjekë janë larguar nga Kosova, 300 janë të papunë

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Grupi për Ballkan ka publikuar raportin "Shëndetësia në Kosovë: Emigrimi i mjekëve dhe punëtorëve shëndetësorë", duke ofruar statistika dhe rekomandime se si duhet të veprojnë institucionet e vendit.

Arieta Dragusha, nga Grupi për Ballkan, ka theksuar se ikja e mjekëve tregon një mungesë perspektive në vend. Sipas raportit të këtij grupi nga viti 2018 deri në shtator të vitit 2022 janë lëshuar 666 certifikata të etikës dhe profesionit, dokument ky që kërkohet nga institucionet shëndetësore me rastin e punësimit të mjekëve dhe infermierëve jashtë Kosovës, kurse vetëm nga janari deri në shtator të 2022-s janë lëshuar 183 certifikata

të tilla.

Prandaj u bë thirrje që të rritet me urgjencë buxheti për sektorin e shëndetësisë duke iu afruar mesatares së BE-së prej 9.9-përqindësh të bruto-produktit vendor.

Ifran Krasniqi nga Ministria e Shëndetësisë ka treguar se këtë vit kjo ministri ka rritur buxhetin për shëndetësinë. "Me ligjin e ri kemi ndarë 98 milionë euro, 300 pozita të reja, 42 pozita të reja në inspektorat. Kemi shtuar buxhet për lista esenciale. Po ashtu, kemi paraparë udhëzimin administrativ, së fundi kemi nënshkruar një marrëveshje me USAD-in për të na ndihmuar për menaxhimin e financave", ka thënë ai.

Naser Gjonbalaj, nga Oda e Mjekëve e Kosovës, ka bërë me dije se nga janari kanë ikur mbi 200 mjekë nga Kosova dhe se rreth 300 mjekë të tjerë janë të papunë.



Hamza rithekson bashkëpunimin me ambasadën e ShBA-së



MITROVICË, 15 DHJETOR - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur në takim përfaqësuesit e Ambasadës Amerikane nga sektori për politikë dhe ekonomi, në krye me Jillian Itharat, Agron Ramaj si dhe Ana Sariç. Gjatë këtij takimi është diskutuar çështja e sigurisë në Mitrovicë, bashkëpunimi i ndërsjellë, mundësitë e mbështetjes dhe përkrahjes nga ana e Ambasadës Amerikane në Kosovë.

Hamza fillimisht ka falënderuar mysafirët për përkrahjen dhe mbështetjen e vazhdueshme të Ambasadës Amerikane dhe popullit amerikan për vendin tonë, më pas ka shprehur shqetësimet e tij për situatën aktuale të sigurisë në veri, duke theksuar se zgjidhje për

përmirësimin e situatës aktuale është dialogu.

Më tutje kryetari Hamza është zotuar se do ta vazhdojë angazhimin e tij të paepur me të gjitha institucionet dhe komunitetet të cilave u shërben, duke përsëritur thirrjen për t'u përmbytur nga veprimet që mund të nxisin tensione.

Ndërsa përfaqësuesja e Ambasadës Amerikane në Prishtinë, Jillian Itharat, shprehu mirënjohjen për thirrjet e kryetarit Hamza për ta ruajtur qetësinë dhe sigurinë si dhe për të punuar në dobi të paqes dhe stabilitetit. Po ashtu, nga Jillian Itharat është potencuar mbështetja për udhëheqjen komunale të Mitrovicës në misionin e përbashkët të paqes dhe stabilitetit të qëndrueshëm në rajon.

Nënshkruhet marrëveshja për 30 autobusë të rinj për kryeqytetin

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka nënshkruar marrëveshjen për kredi prej 10 milionë eurosh me BERZh-in, në selinë e tyre në Londër. Kjo kredi do të përdoret për blerjen e 30 autobusëve, gjashtë prej të cilëve janë autobusë elektrikë me bateri dhe njëzet e katër të modelit Euro VI, së bashku me

infrastrukturën për karikimin e tyre.

Autobusët Euro-VI janë autobusë të rinj me naftë në përputhje me standardin e emetimeve Euro-VI, i cili kufizon emetimet që ata prodhojnë.

Kryetari i kryeqytetit Përparim Rama gjatë nënshkrimit të kësaj marrëveshje ka thënë se inkorporimi i autobusëve të

parë elektrikë në qytet dhe në vend është një moment kyç drejt tranzicionit të gjelbër. "Kjo do të ketë një ndikim të prekshëm në jetën e qytetarëve tanë dhe do të ndërmarrë hapa kuptimplotë drejt një Prishtine më të shëndetshme dhe më të pastër. Jemi shumë krenarë që vazhdojmë një bashkëpunim të ngushtë me partneren tonë BERZh", ka thënë Rama.



Reagim i KMDLNj-së

Gjykata Speciale, instrument i dhunës i Borrellit kundër Kosovës

Joseph Borrell, një "lehtësues" në bisedimet për "normalizim" të marrëdhënieve, jo njohjes reciproke midis Kosovës dhe Serbisë, në shumë raste shkeli parimin e paanshmërisë duke anuar kah Serbia tash, së fundi doli me një deklaratë, gënjeshtër e kulluar se Hashim Thaçin e paska burgosur policia e EULEX-it apo e BE-së për ta dërguar në burgun në Amsterdam ku edhe do të gjykohe! Borrelli nuk e di apo nuk do ta di se Hashim Thaçi u dorëhoq nga posti i presidentit për t'u përballur me një situatë që e improvizuan Serbia, me instrumentet e korruptuara si puna e senatorit të Kaligules, Dik Marti dhe dikmartët tjerë si është edhe Joseph Borrell. Trafikimi me organe ishte zhurmuesi që i heshti tërë zërat e arsyes për të kundërshtuar një raport çoroditës të Dik Martit pas së cilës u themelua një Task Force dhe, si rrjedhojë, në kushte të frikësimit dhe terrorit psikologjik u formua Gjykata Speciale. Edhe raporti i Dik Martit, edhe hetimet si dhe aktakuzat u ndërtuan në bashkëpunim dhe bashkëveprim me inteligjencën serbe, prokurorinë për krime lufte të Serbisë të cilët siguruan shumicën e materialeve sikur edhe dëshminë e mbi 450 dëshmitarëve. Në mesin e këtyre dëshmitarëve ka edhe shqiptarë, të rekrutuar dhe të instruktuar nga inteligjenca e Serbisë, civile dhe ushtarake. Kjo gjykatë është njëetnike, që nga roja në hyrje të saj e deri te niveli më i lartë kurse të akuzuarit dhe të dënuarit janë të gjithë shqiptarë. Nga aspekti i të drejtave të njeriut është raciste kurse nga aspekti i të drejtave të viktimave është diskriminuese dhe dhunuese sepse mohon drejtësinë për më tepër se 95 për qind të viktimave shkaku se i përkasin shqiptarëve. Gjykata Speciale ka shitur ose ka provokuar rrjedhjen e materialeve të ndjeshme për të përshpejtuar arrestimin e krerëve kryesorë shtetërorë të Kosovës të cilët ishin edhe themelues të UÇK-së sikur që e shpallën Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Në të njëjtën kohë dënuan me dënime drakonike Hysni Gucatin dhe Nasim Haradinaj e duket se kështu do ta bëjnë edhe me Salih Mustafën nesër kur edhe do të shpallet vendimi i Gjykatës së



Inkuizicionit. Askush nuk u hetua apo u dënua për rrjedhje të qëllimshme të materialeve të ndjeshme për të cilat KMDLNj mbanë përgjegjës Ekateriana Trandafiloven dhe ish-prokrustin, Jack Smith, tash i dezertuar nga Gjykata Speciale. KMDLNj që nga fillimi e ka kundërshtuar karakterin, qasjen dhe përbërjen njëetnike të kësaj gjykate dhe ka kërkuar nga deputetët e Kuvendit të Kosovës të bëjnë një amendament me të cilin do të sigurohej drejtësi për të gjitha viktimat dhe përgjegjësi për ata që kanë bërë krime përmes një gjykimi të drejtë, të pavarur dhe të pandikuar politikisht e që qartazi Gjykata Speciale nuk e ka asnjëherë prej tyre. Për fat të keq, përbërja aktuale e Kuvendit të Kosovës dhe institucioneve kryesore të vendit, jo që duan të angazhohen të respektohen parimet e lartpërmendura por kanë vullnet dhe gatishmëri t'ua bëjnë jetën sa më të rëndë të arrestuarve të kësaj gjykate duke bërë deklarata të papërgjegjshme, duke bërë vizita selektive dhe duke ua

vështirësuar mbrojtjen. Deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet të këmbëngulin që gjykata të jetë më transparente sa i përket të drejtave të njeriut, monitorimit të pavarur dhe jopërrjashtues, lehtësimi të vizitave familjare dhe krijimit të kushteve për mbrojtje për mbrojtësit nga Kosova, nëse ende mendojnë se kjo gjykatë është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës, në të kundërtën duhet të pajtohen me mashtruesin ndërmjetësues të BE-së, Joseph Borrell se kjo gjykatë është e BE-së. KMDLNj e ndanë këtë mendim duke pohuar se kjo gjykatë me asgjë nuk i përket sistemit të drejtësisë së Kosovës. Prandaj, deputetët e Kuvendit të Kosovës duhet ta thërrasin një seancë ku do të ftohen të gjithë aktorët relevantë, nëse mendon se është themeluese e kësaj gjykate, në të kundërtën duhet të deklarohet publikisht se nuk ka asgjë me këtë gjykatë dhe se nuk është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës. Institucionet e Kosovës duhet të sqarojnë publikun pse u

liruan serbët që për një kohë u mbajtën në burg sepse kërkonin të rekrutonin persona që do të dëshmonin se u ishin hequr organet për një kompensim deri në 300.000 euro. Në krye të këtij grupi ishte një serb nga Serbia, anëtar i BIA-së dhe policë serbë të Kosovës. Kishte edhe gazetarë nga Kosova dhe "hulumtues" të pavarur që i thyenin këmbët duke kërkuar ndonjë organ të mbetur të trafikuar dhe për t'ia dërguar Dik Martit. Gjykata Speciale është përdorur dhe po përdoret si mjet për t'i bërë presion politik në bisedime me Serbinë dhe për ta ndryshuar historinë përmes amnistimit të Serbisë dhe kriminalizimit të luftës çlirimtare të UÇK-së. Nuk ka asnjë rast të vetëm në botë, që nga Gjykata e Nurembergut dhe Tokios, pas luftës së dytë botërore e deri më sot që një gjykatë të jetë aq e anshme dhe paragjyquese duke vepruar ekskluzivisht në baza etnike. Asnjë shtet normal nuk do ta pranonte një situatë kur arrestohen udhëheqësit më të lartë politikë dhe bartësit

kryesorë të luftës çlirimtare sikur edhe krijues të shtetit mbi bazën e akuzave të ndërtuara thujaja 90 për qind nga dëshmi dhe dëshmitarë të një shteti që ka kryer krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në Kosovë, Serbia që edhe sot e kësaj dite po i bënë të njëjtat veprime, tash me mjete politike. Nuk arsyetohet heshtja e Kuvendit të Kosovës për faktin se deputetët e Kuvendit e kanë fituar mandatin për t'i përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e qytetarëve të Kosovës e jo për t'i dëgjuar pallavrat e Botrellit. Kosova, ose duhet të sillet dhe veprojë si shtet i pavarur dhe sovran, edhe nëse duhet të paguajë një çmim të caktuar për këtë, ose do të zhbëhet me ndërmjetësimin e Borrellit që po e kërcënon Kosovën, por jo edhe Serbinë duke e shtyrë statusin përfundimtar për një afat të pacaktuar dhe duke e legalizuar federalizimin e Kosovës përtej Pakos së Ahtisarit. Gjykatën Speciale po e përdorin si mjet për këtë qëllim.

FSK-ja hap konkurs për pranimin e 612 ushtarëve të rinj

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Ministria e Mbrojtjes ka shpallur të hapur konkursin për rekrutimin e 612 ushtarëve aktivë dhe 388 pjesëtarëve të komponentës rezervë të FSK-së. Ministria e Mbrojtjes njofton të gjithë të rinjtë e të rejat se mundësia e

konkurrimit është për të gjithë të interesuarit për aplikim nga moshë 18-25 vjeç, shtetas të Republikës së Kosovës. "Konkursi është i hapur prej 15.12.2022 deri më 15.01.2023. Për informata plotësuese mund të kontaktoni në nr. tel. 038- 555584 2044 dhe 038-

555584 2045 nga ora 09:00 deri 15:00. Ministria e Mbrojtjes, të gjithë të interesuarve u garanton proces të drejtë dhe transparent, në zbatueshmëri të plotë të procedurave dhe kriterëve, ku do të zgjidhen më të mirët prej më të mirëve", ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes.



Mbahet sesion informues me bizneset e diasporës


PRISHTINË, 15 DHJETOR - Në fillim të kësaj jave në Bruksel është mbajtur sesioni informues me bizneset e diasporës me temën "Mjedisi i biznesit dhe klima e investimeve në Kosovë". Përfaqësuesi nga ATK-ja, Sami Salihu, drejtor i Departamentit për Regjistrim dhe Shërbim të

Tatimpaguesve, ka paraqitur funksionimin e sistemit tatimor në Kosovë me theks të veçantë përparësitë e sistemit tatimor. Ajo çfarë u theksua në këtë sesion ishte rreth informimit se ligjet tatimore në Kosovë dhe aktet nënligjore janë të bazuara në standardet ndërkombëtare

dhe parimet e BE-së. Po ashtu, Salihu përmendi edhe reformat e institucionit të ATK-së si mjedis i përshtatshëm biznesor, duke ofruar të gjitha shërbimet për tatimpaguesit në mënyrë elektronike. Gjithashtu, bizneset e diasporës u njoftuan se në Kosovë normat tatimore

janë të ulëta dhe më të favorshme krahasuar me vendet në rajon dhe gjetiu, si dhe të gjitha tatimet deklarohen në mënyrë elektronike. Pjesëmarrësit nga diaspora u njohën me progresin e ATK-së në inkasimin e të hyrave,

lehtësirat në pagesën e tatimeve, si dhe për synimet e ATK-së në të ardhmen. Ky aktivitet është bashkërenduar mes Ambasadës së Republikës së Kosovës në Belgjikë dhe Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë.



Inflacioni ngadalëson rritjen botërore të pagave



Gjenevë, 15 dhjetor - Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) ka zbuluar se kriza botërore e inflacionit, e shoqëruar me rritjen e dobët ekonomike dhe perspektivën e paqartë nga pasiguritë, ka sjellë një rënie të pagave reale në mbarë botën. Sipas raportit të Pagave 2022-2023, pagat reale mujore në nivel botëror kanë rënë mesatarisht 0.9 për qind këtë vit, duke shënuar kështu rënien e parë të të ardhurave reale në shkallë botërore në shekullin e fundit. "Krizat e shumta globale me të cilat po përballemi kanë sjellë

një rënie të pagave reale. Kjo i ka vendosur dhjetëra miliona punonjës përballë një situatë të tmerrshme, ku pasiguritë janë duke u shtuar", tha në një deklaratë drejtori i përgjithshëm i ILO, Gilbert Houngbo, duke shtuar se "pabarazia në të ardhura dhe varfëria do të rriten nëse nuk mbrohet fuqia blerëse e atyre që paguhen më pak". Ndërkohë që inflacioni u rrit më me shpejtësi në vendet me të ardhura të larta, duke sjellë rënie mbi mesataren e pagave reale në Amerikën e Veriut me minus 3.2 për qind dhe në

Bashkimin Evropian me minus 2.4 për qind. ILO ka zbuluar se personat me të ardhura të ulëta janë prekur në mënyrë disproporcionale nga rritja e inflacionit. Duke qenë se ata me paga më të ulëta shpenzojnë një pjesë më të madhe të të ardhurave të tyre për mallra dhe shërbime thelbësore, të cilat përgjithësisht pësojnë rritje më të shumta të çmimeve sesa artikujt jothelbësorë, kjo kategori përballet me ndikimin më të madh të kostos së jetesës nga rritja e çmimeve.

Kuvendi nuk e dyfishon buxhetin për rrugën Prishtinë - Podujevë

PRISHTINË, 15 DHJETOR - Kuvendi i Kosovës nuk ka miratuar amendamentin e deputetit të Lëvizjes Vetëvendosje, Driton Hyseni, për dyfishimin e buxhetit për rrugën Prishtinë - Podujevë. Deputeti i mazhorancës, në seancën e së enjtes ku është shqyrtuar në lexim të dytë buxheti për vitin 2023, tha se në kodet buxhetore për rrugën Prishtinë - Podujevë duhet të shtohen edhe gjashtë milionë euro. Dyfishimi i buxhetit për këtë rrugë, Hyseni ka thënë se

është domosdoshmëri për qytetarët në atë pjesë. "Ndërtimit të rrugës Prishtinë - Podujevë t'i shtohet shuma prej gjashtë milionë eurosh, që është planifikuar në buxhetin për vitin 2023. Pra të dyfishohet dhe të kemi 12 milionë euro për këtë projekt", ka thënë ai. Megjithatë, këtë amendament nuk e mbështetën bashkëpartiakët e Hysenit në grupin parlamentar të LV-së, përveç shtatë deputetëve që janë nga rajoni i Podujevës. Ndërkaq, partitë opozitare u

shprehën pro tij. Derisa i paraqiti rezultatet e votimit të këtij amendamenti, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, tha se ky propozim nuk kalon për gjysmë vote. "Për gjysmë vote nuk kalon, 75 deputetë kanë votuar, 37 për, 34 kundër, katër kanë abstenuar. S'kalon amendamenti 28", ka thënë ai. Amendament të ngjashëm për dyfishimin e buxhetit për rrugën Prishtinë - Podujevë paraqiti edhe deputeti i PDK-së, Isak Shabani.



Këmbimi i robërve të luftës mes UÇK-së dhe Ushtrisë jugosllave



PhD (C) Miftar KURTI

(Sipas shtypit shqiptar, serb, malazias, francez, gjerman, italian, spanjoll, britanik dhe amerikan)

Në luftën e Kosovës 1998-1999, Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) dhe Ushtria Jugosllave (UJ) luftuan për kauza krejt të ndryshme. E para luftonte për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, e dyta për ta bërë spastrimin etnik të Kosovës nga shqiptarët dhe për ta mbajtur atë edhe më tej të pushtuar. Gjatë luftës u vranë, u plagosën, u zhdukën dhe u zunë robër ushtarë e komandantë. Zënia rob, mënyra e trajtimit, arritja e marrëveshjes për këmbimin e tyre dhe mënyra se si është paraqitur kjo temë në faqet e shtypit të kohës, përbëjnë esencën e këtij punimi.

Për këtë temë janë publikuar rreth 130 artikuj në shtypin shqiptar, serb, malazias, francez, gjerman, italian, spanjoll, amerikan dhe britanik. Artikujt janë publikuar në gazeta vendore e ndërkombëtare: Koha ditore, Kosova sot dhe Bota e re (Kosovë); Zëri i popullit dhe Ushtria (Shqipëri); Glas javnosti, Vreme, Nin dhe Republika (Serbi); Vijesti dhe Pobjeda (Mali i Zi); Le Monde, Liberation, Le Telegramme, Lorientjour dhe Lexpress (Francë); Frankfurter Allgemeine Zeitung (Gjermani); La Stampa dhe La Repubblica (Itali); El Pais dhe El Mundo (Spanjë); The New York Times; The Guardian (ShBA dhe Britani) etj.

Në shtypin shqiptar në Kosovë dhe

Shqipëri, nga data 9 deri më 26 janar 1999, janë botuar artikuj në gazetate: Koha ditore,[1] Kosova sot,[2] Bota e re,[3] Zëri i popullit[4] dhe Ushtria.[5] Se çfarë është thënë e shkruar në shtypin shqiptar, kam shkruar edhe më herët. Në asnjë mënyrë nuk kam lënë anash as agjencinë Kosova Press dhe Radion Kosova e Lirë (organe të UÇK-së), të cilat, po ashtu, i kam përdorur më herët si referenca.[6] Vonë kam kuptuar se edhe gazeta Zëri i Kosovës ka publikuar artikuj për këtë temë mirëpo, për shkak të kohës së kufizuar për dërgim për botim të këtij punimi, nuk kam arritur të siguroj ekzemplarë të saj. Prandaj, për shkak të natyrës së punimit dhe me qëllim që të mos përsëriten gjërat, kësaj radhe do të merrem më shumë me qasjen e shtypit ndërkombëtar.

Në shtypin serb dhe malazias,[7] me gjithë përpjekjet e regjimit që të kalojë në heshtje këtë temë, janë botuar artikuj në gazetate: Glas javnosti,[8] Vreme,[9] Nin[10] dhe Republika[11] (Serbi), Pobjeda[12] dhe Vijesti[13] (Mali i Zi).

Edhe në shtypin shqiptar, edhe në shtypin serbo-malazias, por edhe në atë evropian e botëror janë trajtuar çështje që u japin përgjigje pyetjeve se kur, ku, nga kush dhe si janë zënë rob, por edhe si janë trajtuar ushtarët e UÇK-së nga UJ-ja dhe anasjelltas. Shkojmë me radhë.

Më 14 dhjetor 1998, në zonën kufitare me Shqipërinë, më saktë te "Likenet e Hasit" në Gorozhub të Pashtrikut, UJ ka vrarë në pritë 36 ushtarë të UÇK-së, kurse i ka zënë rob 9 të tjerë.[14] Ushtarët që

u zunë rob ishin: Enver Krasniqi, Xhavit Krasniqi, Ismet Krasniqi, Azem Suma, Blerim Spahiu, Nazmi Ballazhi, Samed Ballazhi, Sherif Balazhi dhe Merita Ramadani.[15]

Sipas gjeneralit të Ushtrisë Jugosllave, Bozhidar Deliq, i cili në atë kohë ishte komandant i Brigadës 549 të Motorizuar, ushtarët e asaj brigade të Korpusit të Prishtinës kanë zënë rob 9 ushtarë të UÇK-së. Ushtari me emrin e koduar "Soko 22", të cilin e përdorte për komunikim në Motorola, si njëri nga pjesëmarrësit e pritës, për Telegraf-in serb rrëfen se si në orët e para të mëngjesit të datës 13 dhjetor (1998, M. K.) kishin marrë urdhër për t'u nisur nga fshati Planeja në kullën e rojës Liken me qëllim që të organizonin pritë kundër UÇK-së në thellësi të kufirit. Pika e nisjes ishte 710 metra mbi nivelin e detit. Ata kishin zgjedhur një hapësirë 1 150 metra për vendin e pritës. Prita ishte ngritur taktikisht. Ajo ishte e përgatitur në atë mënyrë që t'i mbulononte tre drejtime. Kishin vendosur edhe mina... Atë mbrëmje, sipas ushtarit "Soko 22", gjysmë ore para mesnate dëgjua zhurmat nga drejtimi i kufirit... I pritëm që të afroreshin sa më afër... Kur ata hynë në territorin tonë..., ne hapëm zjarr mbi ta. Kështu filloi lufta. Ata qëlluan drejt nesh nga disa pozicione... Të shtënat e forta të armëve zgjatën deri në mëngjes. Vetëm në agim patëm mundësi t'i shikonim dhe t'i numëronim të vrarët. Aty mbetën të vrarë 36 pjesëtarë të UÇK-së, kurse u zunë rob 9 të

tjerë.[16] Ata u dërguan në Gjykatën Ushtarake të Armatës së Tretë në Nish të Serbisë.[17]

Për mënyrën se si janë zënë dhe trajtuar ushtarët e UÇK-së rrëfen dhe dëshmon më së miri Enver Krasniqi, një nga të zënit rob, i plagosur shumë rëndë.

Më 14 dhjetor 1998, diku rreth orës 5:30 ose 6:00 të mëngjesit, 147 ushtarë të UÇK-së kemi ra në pritë para se të hynim në fshatin Lubizhdë të Hasit. Nga prita e organizuar nga Ushtria Jugosllave vriten 36 ushtarë të UÇK-së, të udhëhequr nga komandant Mujë Krasniqi-Kapuçi. Aty jam plagosur edhe unë. Ngase isha i plagosur rëndë dhe nuk mund të ecja, atëherë forcat serbe më zunë rob së bashku me 8 ushtarë të tjerë. Shokët i morën dhe i nisën për Prizren, kurse unë mbeta aty tërë ditën dhe tërë natën me trupat e të vrarëve, i futur në një thes. Të nesërmen erdhi helikopteri për t'i marrë trupat e pa jetë. Bashkë me ta, në një thes, më kanë futur edhe mua dhe na kanë nisur për në Prizren... Në Prizren, në kazermën ushtarake, na kanë mbajtur deri kah mesdita. Aty erdhën OSBE-ja, i morën emrat dhe mbiemrat tanë, bënë ca fotografi dhe ecën, kurse ne na lanë në duart e forcave serbe. Shokët që ishin zënë rob, i morën menjëherë, kurse mua më lanë prapë me kufoma, të mbyllur në thes, deri në mëngjesin e 15 dhjetorit. Aty na kanë maltretuar shumë. Më 16 dhjetor, me helikopter, na kanë dërguar në Kazermën Ushtarake në Nish të Serbisë. Atje vazhdoi terrori. Më 17-18 dhjetor më dërguan në sallë operacioni... Derisa më kanë

mbajtur në spital, kanë ardhur e ma kanë shqiptuar dënimin 10 vjet burg me mundësi vazhdimi. Në spital më kanë mbajtur deri më 31 dhjetor, pastaj më kanë dërguar në Kazermën Ushtarake në Nish, ku më kanë mbajtur deri më 23 janar 1999. Më 23 janar kanë ardhur OSBE-ja dhe na ka marrë pasi ishte arritur marrëveshja për këmbimin e robërve të luftës.[18]

Në mesin e të zënëve rob, siç shkruan gazeta italiane La Repubblica, datë 29 janar 1999, në artikullin me titull Ne, gratë e UÇK-së, luftëtarët për liri, përveç të plagosurve, kishte edhe në moshë të mitur, siç ishte rasti i 16-17 vjeçes Merita Ramadani. Për gazetën në fjalë ajo, ndër të tjera, rrëfen:

Më arrestuan teksa po kaloja kufirin me Shqipërinë natën e 14 dhjetorit. Shkova të marrë disa shokë të plagosur. Forcat serbe na zunë rob dhe na çuan në burg, na morën në pyetje, na mbanin në këmbë për orë të tëra, por edhe na rrihnin me shkopinj. Prokuroria për mua kishte kërkuar 25 vite burg. E kuptova që më liruan vetëm kur më futën në veturën e OSBE-së,[19] pasi ishte arritur marrëveshja për këmbimin e robërve të luftës.

Ismet Mazreku, një ushtar tjetër i UÇK-së, po ashtu i zënë rob më 14 dhjetor '98, pas lirimimit kishte rrëfyer për gazetën Koha ditore për tmerret që ai me shokët kishin përjetuar. Sipas tij, që nga momenti i zënies rob, gjatë tërë rrugës na kanë rrahur, derisa kemi arritur në kazermën ushtarake në Prizren'. Pastaj „tërë natën kemi qenë të detyruar të qëndronim në



këmbë. Për tri ditë me radhë na kanë rrahur pa na dhënë asgjë për të ngrënë. Më kanë rrahur derisa më kanë rënë thonjtë e këmbëve. Ai nga Gjykata Ushtarake në Nish, me procedurë të shpejtë, ishte dënuar me dhjetë vjet burg.[20] Vrasjen në pritë të 36 ushtarëve të UÇK-së dhe trajtimin mizor të 9 të tjerëve të zënë rob, në mesin e të cilëve kishte të plagosur rëndë dhe të mitur, gjenerali Veselin Sljivanqanin e quan vepër heroike të ushtarëve të UJ-së që nuk duhet të harrohet kurrë.[21] Me barbari të tilla krenoheshin gjeneralët e UJ-së, me mizori të tilla vazhduan edhe në ditët e para të muajit janar të vitit në vijim. Më 3 janar 1999, rreth orës 22:00 të natës, te varrezat e fshatit Smrekonicë të Vushtrisë, forcat serbe vranin në një pritë ndihmëskomandantin për Logjistikë të Zonës Operative të Shalës (ZOSH), Xhevat Jusufin, kurse plagosin rëndë zëvendëskomandantin e Brigadës 141 Mehë Uka, Zymer Halimin. Mirëpo as Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk qëndroi duarkryq. Pesë ditë më vonë, saktësisht më 8 janar 1999, rreth orës 11:30, në hyrje të fshatit Bare, pak kilometra mbi Minierën Trepça në Stantërgu (komuna e Mitrovicës), Policia Ushtarake, së bashku me Njësinë Speciale të Brigadës 141 Mehë Uka të ZOSH, zunë rob një skuadër (7 ushtarë dhe 1 rreshter) të UJ-së derisa po tentonte të futej në territorin që e mbante nën kontroll UÇK-ja.[22] Ushtarët e zënë robër ishin: Nikolla Cvijoviq, Robert Çekanoviq, Aleksandar Subotiq, Nenad Joviçeviq, Marko Pavloviq, Aleksander Millashinoviq, Ivan Kostiq dhe rreshteri Dragan Jugoviq.[23] Sipas gazetës serbe Vreme, në mëngjesin e ditës së premte, më 8 janar 1999, në afërsi të vendbanimit minerar Stanterg, në pjesën e Kosovës të malit Kopaonik, skuadra e policisë ushtarake ishte kthyer me

shpejtësi në vendin e gabuar dhe kishte hasur në patrullën e UÇK-së në fshatin Bare. Skuadra ishte rrethuar dhe ishte detyruar të dorëzohet pa rezistencë, sepse rezistenca e mundshme do të ishte e kotë dhe vetëvrasëse.[24] Ishte hera e parë që gjatë nëntë muajve të luftës në Kosovë pjesëtarët e UÇK-së kishin arritur të zinin rob ushtarë jugosllavë,[25] shkruan në një artikull të saj gazeta franceze Liberation, por jo vetëm.

Reagimet nga Serbia ishin të ashpra. Partia Demokratike e Zoran Gjingjiqit, pasi kishte shprehur indignatën për zënien rob të policëve ushtarakë të Brigadës 125 të motorizuar të UJ-së, deklaronte se çdo qytetar i Serbisë duhet ta shtrojë pyetjen se çka është bërë deri më tash për t'u shmangur tragjeditë e tilla... Pra, në Serbi akti i zënies rob të ushtarëve të tyre konsiderohej tragjedi.[26] I ashtuquajtur i Këshilli Kombëtar i Kosovës dhe Metohisë, në emër të të cilit fliste edhe iniciatori për formimin e këtij Këshilli, Marko Jakshiq, zënien rob e shihet si shenjë të qartë të dobësisht të pushtetit qendror serb në Kosovë...[27] Pavarësisht prej reagimeve të ashpra të partive politike (kryesisht opozitare), as qarqet zyrtare, as mediet shtetërore serbe jo vetëm që nuk i kishin dhënë publicitet zënies rob të ushtarëve të tyre, por edhe ishin përpjekur ta mbanin të fshehur.[28]

Shtypi shqiptar dhe ndërkombëtar, ndryshe nga ai serbo-malazias, i japin hapësirë të konsiderueshme zënies rob të ushtarëve, por edhe e paraqesin një gjendje dramatike si në rrafshin ushtarak, ashtu edhe në atë politik dhe diplomatik. Për këtë kanë shkruar, përveç gazetave shqiptare, edhe gazetave franceze: Le Telegramme,[29] Lorientjour[30] dhe Lexpress[31]; gjermane:

Frankfurter Allgemeine Zeitung;[32] italiane: La Stampa;[33] spanjolle: El Pasi;[34] amerikane: New York Times[35] dhe britanike The Guardian.[36] Siç mund të lexohet në faqet e shtypit, në rrafshin ushtarak Ushtria Jugosllave kishte pozicionuar njësi tankiste në zonën përreth Mitrovicës,[37] duke përfshirë transportues të blinduar.[38] Tanket ishin pozicionuar edhe në Stanterg 6-7 km larg nga Bajgora, ku mbaheshin ushtarët e UJ-së.[39] Dhjetëra tanke të tjera ishin në gatishmëri për të sulmuar nga Podujeva.[40] Një konvoj me 3 kamionë dhe 7 xhupa me ushtarë dhe policë kishte arritur nga qyteti i Vushtrisë në Studimen e Epërme,[41] jo larg Bajgorës. Në Smrekonicë të Vushtrisë, në hyrje të rrugës që shpinte në Shalë të Bajgorës, ishin pozicionuar forca të shumta ushtarake dhe policore, të cilat mbanin nën kontroll çdo lëvizje.[42] Gjithashtu, Brigada 125 e motorizuar, e vendosur në bazën ushtarake të UJ-së në fshatin Kutlovci të Mitrovicës, e cila në vijë ajrore nuk ishte në distancë më të largët se 3-4 km nga vendi ku po mbaheshin ushtarët, ishte në gatishmëri të lartë për të sulmuar.[43] Vetëm brenda një ore në mëngjesin e 11 janarit nga Serbia kanë hyrë në Kosovë rreth 100 transportues (autoblinda, kamionë dhe mjete të tjera ushtarake e policore).[44] Kështu, forcat serbe, me gjithë këto forca, ishin përgatitur për ta sulmuar Shalën nga tri drejtime: nga Trepça dhe Mitrovica, nga Vushtrria, por dhe nga Podujeva. Mirëpo, edhe pse UJ kishte dërguar radhazi 3 ultimatumë për lirim pa kushte të atyre ushtarëve, UÇK-ja refuzoi t'i bindej çfarëdo ultimatumit.[45] Para një vendosmërie të tillë të UÇK-së, atëherë UJ, në mbrëmjen e 9 janarit hoqi dorë nga ultimatumet.[46] Pas një

kundërultimatumi të UÇK-së, se nëse forcat serbe nuk tërhiqeshin menjëherë nga Stantërgu do të sulmoheshin, UJ-ja u detyrua të tërhiqet. Tërheqjen e forcave ushtarake e policore nga Stantërgu e kishin konfirmuar shumë gazetarë që ishin në vendin e ngjarjes, e kishte konfirmuar edhe agjencia beogradase e lajmeve Beta, por edhe zëdhënësi i Qendrës Rajonale të MVK-së në Mitrovicë, Heintz Nitch.[47] Forcat serbe ishin detyruar të largoheshin edhe nga rruga kryesore ku mbaheshin ushtarët e zënë.[48] Në ato ditë të acarta dimri Ushtria Çlirimtare e Kosovës po ballafaqohej me presionin ushtarak të Ushtrisë Jugosllave, me presionin publik të MVK të OSBE-së, por edhe me presionin politik e diplomatik të disa shteteve perëndimore. Në njoftimin për shtyp, më 9 janar 1999, OSBE fajësonte (publikisht) UÇK-në se është fajtorë për tensionimin e situatës, kurse e lavdëronte UJ-në për vetëpërmbytje dhe për gatishmëri për të bashkëpunuar në atë situatë.[49] Kryesuesi i kësaj organizate, Knut Vollebaeck, këmbëngulte se Ushtria Çlirimtare e Kosovës është e detyruar t'i lirojë pengjet pa kushte.[50] Presioni ishte shtrirë në të gjitha nivelet: në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, në Komandën e Zonës Operative të Shalës (ZOSH),[51] veçan në komandantin e saj Rrahman Rama,[52] në komandën e Brigadës 141, por edhe tek ushtarët që patrullonin në Magjistralen Mitrovicë – Podujevë në rajonin e Shalës së Bajgorës. MVK, gjithashtu, kërkonte nga ushtarët e UÇK-së, të pozicionuar në pozicionet luftarake në Trepçali dhe në Melenicë, të tërhiqeshin nga pozicionet e tyre me arsyetimin se forcat serbe po e konsideronin veten të rrezikuara nga ndonjë sulm i mundshëm i tyre.[53]

Presion për lirim pa kushte të ushtarëve jugosllavë po bënin edhe shtetet, si: Franca, Italia, Gjermani, por edhe Rusia. Qeveria italiane kërkonte lirimin e menjëhershëm dhe pa asnjë kusht të ushtarëve jugosllavë, kurse Qeveria e Francës ishte edhe më e ashpër. Ajo iu bëri demarsh vëzhguesve të OSBE-së që t'i ndërmermin të gjitha masat për lirimin e tyre të menjëhershëm dhe pa kushte.[54] Gjermania kishte kërkuar lirimin e menjëhershëm të ushtarëve të UJ-së. Rusia e konsideronte këtë si "akt flagrant të terrorizimit", por kërkonte nga autoritetet jugosllave të tregojnë vetëpërmbytje në këtë situatë komplekse. Reagime pati madje edhe nga Irani. Përmes zëdhënësit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Hamid Reza Asefi, Irani kërkonte që "palët në konflikt të tregojnë përmbytje dhe që dallimet në mes vete (Kosova dhe Serbia, M. K.), t'i zgjedhin me mjete diplomatike". Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, kërkonte nga UÇK-ja t'i lironte ushtarët jugosllavë, kurse Millosheviqit i kërkonte t'i tërhiqte përforcimet në njerëz dhe armatim nga Veriu i Kosovës dhe të ndalte çfarëdo agresioni kundër fshatrave në rajonin e Shalës së Bajgorës.[55]

Për zënien rob të ushtarëve, për gjendjen dramatike në terren dhe për presionin që po i bëhej UÇK-së, për lirimin pa kushte të ushtarëve jugosllavë, ku më shumë e ku më pak, janë publikuar artikuj në gazetave franceze,[56] gjermane,[57] italiane,[58] spanjolle,[59] britanike dhe amerikane.[60] Duke qenë se UÇK-ja, pavarësisht prej presionit, ishte kategorike kundër lirimimit pa kushte të ushtarëve jugosllavë atëherë, për të gjetur një zgjidhje, kryesuesi i radhës i OSBE-së, Knut Vollebaeck, gjatë vizitës pesëditore në Ballkan, kishte shkruar edhe në Tiranë për ta

takuar presidentin e Republikës së Shqipërisë, Rexhep Mejdani, kryeministrin Pandeli Majko dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Paskal Milo. Nga zyrtarët e lartë shtetërorë të Republikës së Shqipërisë Vollebeak kërkonte që ta bindnin UÇK-në t'i lironte ushtarët jugosllavë pa kushte.[61] Në Tiranë Vollebeak kishte takuar edhe akademik Rexhep Qosjen, nga i cili kërkonte të ushtronte ndikim tek UÇK-ja për lirim pa kushte të robërve. Edhe Dan Everts, kryesues i OSBE-së në Shqipëri, kërkonte nga akademik Qosja ta ushtronte ndikimin e tij për lirim dhe ushtarëve sepse, sipas tij, lirim i tyre do të mund të shfrytëzohet në të mirë të UÇK-së dhe të shqiptarëve në përgjithësi.[62] Vollebeak kishte shkruar edhe në Serbi për t'u takuar edhe me ministrin e Punëve të Jashtme (MPJ) të RFJ-së, Zhivadin Jovanović dhe presidentin Millošević. Nga këta të fundit kërkonte mundësinë e shtyrjes së ultimatimit të dhënë së fundi edhe nga Milloševići.[63] Ministria e Punëve të Jashtme e Rusisë këtë çështje e kishte dërguar edhe në Këshillin e Sigurimit të KB-së, duke kërkuar që Këshilli të dilte me një deklaratë...[64] Pas një debati të ashpër, Këshilli i Sigurimit nuk kishte arritur pajtimin për miratimin e projektdeklaratës ruse, sepse Projektdeklarata dënonte me forcë aksionet e UÇK-së dhe kërkonte "lirimin e menjëhershëm dhe pa kushte të të gjitha pengjeve të saj. Ambasadori i Sllovenisë, Danilo Turk, kishte kundërshtuar veçanërisht

cilësimet pengje dhe veprimtari terroriste të përdorura nga projektdeklarata ruse. Madje përfaqësuesi slloven kishte theksuar, gjithashtu, se Beogradi ishte pengesa kryesore për paqen dhe jo "indipendistët kosovarë".[65]

Pavarësisht prej presionit të madh nga të gjitha anët, UÇK-ja ishte e vendosur të kërkonte shkëmbimin e ushtarëve jugosllavë me shqiptarët që mbaheshin në burgje. Sipas analistit serb Zoran B. Nikolić, UÇK-ja së pari kërkoi nga pala jugosllave të lirojë të gjithë shqiptarët e burgosur dhe të rrëmbyer, pastaj ajo bëri një kërkesë më të arsyeshme: kërkoi lirim dhe 9 ushtarëve të UÇK-së në këmbim të 8 ushtarëve të UJ-së.[66] Sipas analistit tjetër serb Milloš Vasić, bisedimet e fshehta u zhvilluan me ndërmjetësimin e misioneve të huaja në Kosovë.[67] Për rrjedhën e bisedimeve dhe për arritjen e marrëveshjes për këmbimin e robërve të luftës kanë shkruar edhe prestigjiozët: Liberation,[68] Frankfurter Allgemeine Zeitung,[69] El País[70] dhe New York Times[71]. Nga burime të ndryshme të kohës mësojmë se bisedimet kanë zgjatur nga data 9 deri më 13 janar. Ato janë zhvilluar në zonën e përgjegjësisë ku operonte ZOSH, por edhe në ShP të UÇK-së.[72] Sipas Jakup Krasniqi, i cili ishte një nga përfaqësuesit e UÇK-së në bisedime, takimi i parë me KDOM-in amerikan në krye me Shon Bërns dhe OSBE-në, të cilën e përfaqësonte majori anglez Dejvid, mbahet në Dragobil më 9 janar 1999. Edhe pse majori Dejvid

qysh në takimin e parë bëri presion të madh në përfaqësuesit e UÇK-së për lirim pa kushte të ushtarëve jugosllavë, një gjë e tillë nuk dha rezultate. Takimi i dytë me radhë që mbajtur më 11 janar 1999 në fshatin Drenoc të Vllehtëve në komunën e Malishevës. Në takim, nga ShP i UÇK-së, merrnin pjesë: Jakup Krasniqi, Sokol Bashota, Ramë Buja dhe Adem Grabovci, kurse nga pala ndërkombëtare ndërmjetësuese merrnin pjesë ambasadori amerikan në Shkup, Kristofer Hill dhe ambasadori austriak W. Petriç. Takimi kishte zgjatur mbi pesë orë, por marrëveshje nuk ishte arritur. Takimi i tretë dhe i fundit, mes përfaqësuesve të ShP të UÇK-së, Jakup Krasniqi, Sokol Bashota, Ramë Buja dhe Shaban Shala, në një anë, dhe përfaqësuesve të bashkësisë ndërkombëtare, ambasadori amerikan Hill, i BE-së, Petriç dhe OSBE-së, W. Walker, në anën tjetër, u mbajt në Likoc të Drenicës më 13 janar 1999. Edhe pse kishte rrezik që bisedimet të dështonin, marrëveshja u arrit falë vendosmërisë dhe gjindshmërisë së udhëheqësit të KDOM-it amerikan Shon Bërns, por edhe britanikëve. Më 13 janar, pas pesë orë bisedimesh, në prani të një numri ta madh të gazetarëve, u bë publik lajmi për arritjen e marrëveshjes për këmbimin e robërve. Atë ditë u liruan 8 ushtarët jugosllavë, kurse më 23 janar u liruan 9 ushtarë të UÇK-së.[73]

Nëse lajmi për zënien rob të 8 ushtarakëve jugosllavë, por dhe për arritjen e marrëveshjes ishte publikuar shpejt në medie

shqiptare dhe botërore, akti i lirim të 9 ushtarëve të UÇK-së nga UJ-ja më 23 janar 1999 nuk ishte lejuar të përcillet nga mediet. Pra, asnjë medie nuk ishte lejuar të jetë e pranishme në momentin e dorëzimit të ushtarëve të UÇK-së. Këtë e kishte kërkuar Misioni Diplomatik (KDOM-i) amerikan. Së paku kështu thuhet në një shkrim të gazetës „Koha ditore”. [74] Përtej të gjitha këtyre sfidave, marrëveshjes për këmbimin e robërve, qarqet zyrtare dhe mediet shtetërore serbe jo vetëm që nuk i dhanë publicitet, por përpiqeshin ta mbanin të fshehur. Krejt kjo përpjekje bëhej për ta ruajtur imazhin e vet. [75] Organet zyrtare të RFJ-së, gjithashtu, për arritjen e marrëveshjes nuk kishin lejuar të raportonte as Radio Televizioni i Serbisë (RTS). Ishte gazeta Glas javnosti ajo që kishte raportuar për arritjen e marrëveshjes, duke iu referuar një zyrtari të Qeverisë të RFJ-së... [76] Pra, fshehtësia nuk u ruajt: marrëveshja u zbulua nga publiku. Kjo shkaktoi nervozizëm diplomatik dhe politik në anën jugosllave, sepse pala jugosllave para opinionit publik kishte këmbëngulur që lirim i tetë ushtarëve të UJ ishte "i pakushtëzuar". Natyrisht këtë e kishte bërë që ta ruante imazhin dhe reputacionin... Kjo përpjekje për të ruajtur fytyrën dështoi. [77] Vojislav Koshtunica, kryetar i Partisë Demokratike të Serbisë, me rastin e arritjes së marrëveshjes, kishte vlerësuar se kreu ushtarak e politik i vendit (RFJ-së, M. K.) është pajtuar me kërkesat dhe ultimatimet e UÇK-së, duke bërë kështu një precedent tejet të

rrezikshëm. Sipas tij, UÇK-së i është njohur legjitimiteti, ajo është niveluar me UJ-në, madje në këtë rast ajo edhe ka dalë fitimtare. [78] Ndërkaq zëvendëskryeministri jugosllav Nikola Shainović refuzonte versionin, ku UÇK-ja paraqitej si një bashkëbiseduese dhe pjesë e marrëveshjes. Për ta dëshmuar të kundërtën e asaj që thotë Shainović, mjafton të lexohet një shkrim i veçantë për këtë çështje te gazeta Glas javnosti. Aty citohet një zyrtar... i Qeverisë Federale, i cili në kushte anonimiteti deklaroi se bëhet fjalë për një marrëveshje gojore ndërmjet palës serbe dhe asaj shqiptare. [79] Ndërmjetësit ndërkombëtarë në bisedime, ambasadori Uiliem Uoker, Kristofer Hill dhe Petriç, ishin të kënaqur që Ushtria Çlirimtare e Kosovës i kishte liruar tetë ushtarët jugosllavë, kurse marrëveshjen e quanin fer dhe të balancuar... [80] I rëndësishëm me këtë rast është edhe fakti se shtete të fuqishme perëndimore e kishin mirëpritur marrëveshjen, ndër të cilët vetë ministri i Punëve të Jashtme i Gjermanisë, Joscha Fisher, ministri i Punëve të Jashtme i Francës, Hubert Vedrine, sekretari i jashtëm britanik Robin Kuk. [81] Ndërsa sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, jo vetëm që e kishte përshëndetur arritjen e marrëveshjes, por edhe e cilësonte atë si rreze shprese për paqen në Kosovë. [82] Kjo marrëveshje, sipas një shkrimi në gazetën Le Monde, do të mund të shërbente si bazë për shfaqjen e një zgjidhjeje politike të konfliktit" në Kosovën me shumicë shqiptare. [83]



Nëse askund tjetër, atëherë te burimet serbe gjejmë përgjigjen në pyetjen pse UJ-ja nuk pati guximin të ndërmerre sulm në pozicionet e UÇK-së për t'i liruar ushtarët e saj. Sipas kolonelit të UJ-së, Milan Kotur, kjo ishte arsyeja: Sepse ishte në pyetje policia, ishte policia ushtarake, ishin shtatë policë dhe një nënoficer të Brigadës 125 të Motorizuar me komplet pajisjet... Ata nuk ishin ushtarë të zakonshëm.[84]

Nëse në fillim të punimit kam shkruar se si UJ i kishte keqtrajtuar ushtarët e UÇK-së të zënë rob, atëherë e shoh të arsyeshme t'i them disa fjalë se si UÇK-ja i kishte trajtuar ushtarët jugosllavë. Për këtë çështje janë publikuar shkrime te gazetata shqiptare, te gazeta serbo-malazise, por edhe te gazetata prestigjioze botërore si: Frankfurter Allgemeine Zeitung,[85] La Stampa,[86] El Pais,[87] El Mundo[88] etj. Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila i konsideronte ushtarët jugosllavë si robër lufte, e jo si pengje, siç i quante OSBE-ja dhe një pjesë e shtypit, do t'i trajtonte ata në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare.[89] Ata jo vetëm që nuk i kishte vrarë, plagosur a keqtrajtuar, por u kishte dhënë edhe ushqim e cigare. I lejonte t'i vizitonin e fotografonin zyrtarët e Misionit Verifikues, gazetarë e kameramanë të medie të shkruara dhe elektronike ndërkombëtare. I lejonin edhe t'i kontaktonin familjarët në telefon, t'u shkruanin letra dhe t'u dërgonin fotografi atyre. Një trajtim të tillë gjatë luftës nuk e kishin pasur asnjëherë 9 ushtarët e UÇK-së të zënë rob nga UJ. As ushtarët, as të burgosurit politikë, as pengjet, as fëmijët e pleqtë, as të sëmurit, madje as gratë shtatzëna shqiptare.

Se ushtarët jugosllavë nuk ishin keqtrajtuar në asnjë rast, rrëfen për gazetën spanjolle El Pais komandanti i tyre Dragan Jugović, 28 vjeç: Ata nuk na keqtrajtuat, gjithçka është në rregull.[90] Më herët kishte deklaruar edhe për agjencinë Asocieted Pres. Për trajtimin korrekt dhe sipas konventave ndërkombëtare dëshmon edhe sot e asaj dite videoja e Agjencisë Asocieted Press (AP), e cila ende gjendet në Youtube.[91]

Në video të agjencisë Asocieted Press (AP), shihet një lokal, ndoshta një ndërtesë shkollore, në të cilën ka banka dhe dyshek. Aty shihet se si tetë ushtarët janë ulur dhe pinë cigare. Ushtarët kanë të mbathur çorape. Askush nuk mund të shohë gjurmët e ndonjë keqtrajtimi. "Zotërinjtë e UÇK-së janë shumë korrektë me ne", thotë rreshteri Dragan Jugović dhe ushtari Nikola Cvijović për gazetarët AP,[92] shkruante në atë kohë në një artikull analisti serb Nikoliq për gazetën Vreme.

Një dëshmi tjetër, e publikuar në shtyp, e cila edhe sot e kësaj dite është e qasshme për publikun, që dëshmon se ushtarët jugosllavë janë trajtuar sipas konventave ndërkombëtare, është edhe njoftimi për medie e KVM të OSBE-së, lëshuar më 10 janar 1999, të cilën po e japim të plotë:

PRISHTINË, 10 janar 1999 – Ndërmjetësuesit e KVM të OSBE-së në negociatat për lirim të 8 ushtarëve të UJ-së konfirmojnë se ata i kanë vizituar të burgosurit rreth orës 15:15 të së shtunës të datës 9 janar, por edhe më 10 janar. Ndërmjetësuesit raportojnë se të gjithë të arrestuarit ishin në gjendje të mirë shëndetësore dhe po trajtoheshin mirë. Gjatë vizitës u bënë fotografi dhe të arrestuarit u shkruan letra familjeve të tyre. Letrat dhe fotografitë do t'u kalojnë familjeve të tyre. Ndërmjetësuesit e KVM i OSBE-së kanë vazhduar përpjekjet e tyre ndërmjetësuese gjatë gjithë natës.[93]

Një dëshmi tjetër e pazakonshme

është edhe letra falënderuese që ia kanë dërguar pas luftës komandantit të ZOSh, Rrahman Rama, dy prej atyre ushtarëve.[94] Edhe pse të gjitha burimet e shkruara dhe elektronike, në të cilat unë kam pasur qasje, dëshmojnë se UÇK-ja kishte zënë rob 8 ushtarë të UJ-së, fatkeqsisht ka një rast kur përpiqet ta mohojë atë që nuk e kanë mohuar në asnjë rast as burimet serbe. Është fjala për librin e Shyqyri Nimanit 78 ditë bombardime të NATO-s sipas gazetave britanike. Në faqet 125 dhe 126 të librit gjendet shkrimi i përkthyer nga gazeta The Daily Telegraph, datë 20 janar 1999, me titull Millosheviqi është paralajmëruar për goditjet ajrore të NATO-s. Gazeta ka botuar edhe një grafik me të dhëna për ngjarjet e fundit, ku veçohet edhe zënia rob e 8 ushtarëve jugosllavë nga UÇK-ja. Aty, në gjuhën angleze, shkruan: "Jan 8, 1999: The KLA takes eight Serb soldiers hostage, kurse në gjuhën shqipe është përkthyer kështu: 8 janar 1999: UÇK-ja merr peng tetë serbë.[95]

Siç edhe mund të vërehet fare lehtë, teksti në gjuhën angleze flet se UÇK-ja kishte zënë rob 8 ushtarë, kurse në tekstin në gjuhën shqipe paturpësisht është hequr fjala kyçe e tekstit: ushtarë (soldiers).[96] Pra, sipas këtij teksti, UÇK-ja paska marrë peng serb, por jo ushtarë serbë. Këtë të dhënë kaq skandaloze nuk mund ta gjeni te asnjë artikull gazete shqiptare, serbe, malazeze, franceze, gjermane, italiane, britanike a amerikane. Se me çfarë qëllimi e ka bërë këtë autori i librit, mund ta thotë vetëm ai, porse se po vazhdon të zhvillohet një luftë frontale kundër UÇK-së tash e 23 vjet, kjo nuk mund të mohohet. Ky "lëshim" nuk mund të quhet ndryshe vetëm pjesë e orkestruar e kësaj fushate.

Pavarësisht prej gjithë kësaj, shtypi i kohës merret edhe me epilogun e

ngjarjes. Trajtimi korrekt dhe i mirë që UÇK-ja në të gjitha rastet ua ofroi ushtarëve jugosllavë, u dha atyre pikë në medie, në opinion.[97] Kjo e kishte ngritur shumë imazhin e UÇK-së, e kishte faktorizuar edhe më shumë atë, prandaj edhe burimet serbe e kanë pranuar qysh atëherë se: ...UÇK-ja është fakt i pamohueshëm... Ky formacion është krejtësisht i njëjtë (si ushtritë tjera – M. K.), pavarësisht nëse dikush atë e quan "të ashtuquajtur". UÇK-ja është një fakt i kryer ose një akt i përfunduar, e cila rrjedhimisht e nxjerr legjitimitetin e vet në terren.[98] Dhe në histori. Kjo është histori që vetëm mund të lexohet e mësohet përmendsh, por jo të ndryshohet. Prandaj, siç ka deklaruar atëherë analisti serb Zoran B.Nikoliq, Serbia, pas këtij rasti, ... nuk është më në gjendje ta shkatërrojë UÇK-në me anë të forcës... Tentimi për diçka të tillë do të na kushtonte më shumë se sa duhet të paguajmë,[99] shkruante ai.

Për fitoren ushtarake, politike dhe diplomatike të UÇK-së karshi UJ-së dhe Serbisë kanë shkruar edhe gazetata prestigjioze botërore. Në një analizë të Matthias Rüb, me rastin e arritjes së marrëveshjes, botuar te Frankfurter Allgemeine Zeitung, më 16 janar 1999, ndër të tjera, shkruan: Një shkëmbim i të burgosurve në mënyrë efektive do t'i jepte UÇK-së statusin e një ushtrie. Pse UÇK-ja të mos festojë publikisht çlirimin e suksesshëm të luftëtarëve të saj?[100] Meqë Serbia u detyrua t'i lirojë 9 ushtarë të UÇK-së më 23 janar, shtatë ditë pas publikimit të kësaj analize. Si rezultat i marrëveshjes, ajo ia dha de fakto UÇK-së statusin e ushtrisë, ia dha edhe një fitore të madhe. Kjo fitore ushtarake në terren dhe politike në tavolinën e bisedimeve, sipas një artikulli në shtypin francez, kishte edhe dimension politik e diplomatik.

Këtë dimension UÇK-ja e shfrytëzoi me mençuri. Sipas Pierre Hazan (gazeta Liberation): Për shkak se kunji i vërtetë ishte edhe politik UÇK (me këmbënguljen e saj për arritjen e marrëveshjes për këmbimin e robërve të luftës – M. K.): kërkoi dhe arriti të merrte një njohje më të madhe diplomatike, jo vetëm të bashkësisë ndërkombëtare, por edhe të armikut serb, duke kërkuar një shkëmbim të të burgosurve...[101]

Në këto të përditshme, javore dhe mujore shqiptare, serbe, malazeze, franceze, gjermane, italiane, spanjolle, amerikane dhe britanike, gjejmë lajme, reportazhe, komunikata, intervista, opinione, deklarata, komente dhe analiza. Diskursi është i ndryshëm varësisht nga politika redaktuese e gazetës, varësisht nga gjuha dhe shteti. Fjalët kyçe në diskursin e tyre janë: Kosovë, UÇK, Serbi, UJ, OSBE, ShBA, BE, marrëveshje etj. Sipas ambasadorit U. Uoker, janë tri ngjarje që kanë ndodhur në Kosovë gjatë fundit të vitit 1998 dhe në janarin e vitit 1999 të cilat e kanë përshpejtuar thirrjen e Konferencës Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje në dobi të Kosovës dhe popullit të saj. Njëra nga to, sipas tij, është marrëveshja me bashkësinë ndërkombëtare për lirim të pengjeve të luftës.[102]

Konkluzione

Zënia rob, trajtimi sipas konventave ndërkombëtare dhe arritja e marrëveshjes për këmbimin e robërve, është një nga veprimet më të mençura ushtarake, politike, diplomatike dhe humanitare deri atëherë me të cilën UÇK-ja tërhoqi aq shumë vëmendjen e faktorit relevant ndërkombëtar. Ky veprim i mençur u vlerësua nga faktori



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Argjentinë - Francë, njihuni me shifrat e dy finalistëve

Doha, 15 dhjetor - Botërori i Katarit nisi me surpriza dhe blofe të mëdha. Një prej tyre, mbase më i rëndi, ishte fitorja më përmbysje e Arabisë Saudite ndaj Argjentinës së Leo Messit. Ajo disfatë shkundi në themel ekipin Argjentinës pasi që nga ajo sfidë Messi me shokë morën pesë fitore radhazi duke siguruar një biletë për në finalen e madhe të Botërorit. Në gjashtë ndeshje, Argjentina ka shënuar 12 gola dhe ka pësuar pesë gola. Ndryshe nga Argjentina, Franca e nisi me një fitore me "poker" golash përballë Australisë, duke vërtetuar menjëherë se ishte favorite e këtij turneu. Ekipi i

Deschampsit përsëriti veten me Danimarkën, por e mbylli fazën e grupeve me një bluf përballë Tunizisë. Ashtu si Argjentina, edhe Franca vjen në finale me pesë fitore dhe një humbje. "Gjelat" kanë shënuar 13 gola në gjashtë ndeshje dhe kanë pësuar po aq sa Argjentina, pesë. Lionel Messi është golashënuesi më i mirë i Argjentinës dhe i këtij Botërori me pesë gola dhe tre asistime. "Pleshti" ndiqet nga Mbatpe me pesë gola dhe dy asistime. Barazi totale edhe me ndjekësit e tyre. Me katër gola renditen Alavarez i Argjentinës dhe Olivier Giroud i Francës.



Josa: Asnjë lloj kontakti nuk kam pasur me Dritën



Prishtinë, 15 dhjetor - Ish-trajneri i Prishtinës, tanimë aktual i Vllaznisë së Shkodrës, Mirel Josa, është deklaruar rreth interesimit të Dritës së Gjilanit. Tre herë kampionët e Kosovës janë në kërkim të një trajneri pas largimit të Ardian Nuhiut pak kohë më parë. Mirel Josa, trajneri i mirënjohur shqiptar, është raportuar të jetë në listën e dëshirave të klubit gjilanas. Trajneri nga Shqipëria ka mohuar të ketë ndonjë kontakt me drejtuesit e "bardhekaltërve". "Unë nuk kam pasur asnjë lloj kontakti. Unë respektoj ekipin aktual që jam. Kam një kontratë me të. Nëse ka interesim, sepse kur ka interesim për një person në

skuadër, qoftë trajner, qoftë pjesëtar i stafit, qoftë lojtar, duhet ta respektosh. Ta respektosh interesimin që kanë klubet e tjera karshi teje, por është një problem që unë nuk mendoj shumë për atë punë. Unë mendoj për punën time këtu. Nga Klubi i Dritës unë nuk njoh. Unë njoh vetëm nga Prishtina që kam punuar dy vjet atje", ka thënë Josa në konferencë për medie, njofton "PanoramaSport". Mirel Josa, 59-vjeçar, ka qenë shef i shtabit teknik të Prishtinës për dy vjet. Josa drejtoi kryeqytetasit gjatë viteve 2017-2019. Drita e ka mbyllur stinorin vjeshtor si lidere dhe është në garë për titullin e katërt në histori të klubit.

Rashica është shumë i lumtur në Galatasaray

STAMBOLL, 15 DHJETOR - Milot Rashica ka filluar të lë gjurmë te skuadra e madhe turke Galatasaray. Futbollisti "dardan" është bashkuar me klubin turk si huazim nga Norwich City, derisa dëshira e drejtuesve të Galatasarayt është që ta blejnë përfundimisht Rashicën. Menaxheri i Rashicës, Aykut Erçetin, ka thënë se dëshira e sulmuesit është të qëndrojë në Stamboll, aty ku edhe familja e tij ndihet mirë dhe është e lumtur. "Nuk e dimë ende se sa kërkon Norwich City për të ta lënë të lirë

Rashicën, por do të bëhet e qartë me kohë. Tifozët e Galatasarayt e duan Milotin dhe duan që ai të qëndrojë. Lojtari është, gjithashtu, shumë i lumtur këtu. Familja e tij, gjithashtu, e pëlqen këtë vend dhe ai dëshiron të qëndrojë", ka deklaruar Erçetin. 26-vjeçari ka zhvilluar tetë ndeshje deri më tani me Galatasarayt, duke shënuar dy gola e asistuar në dy të tjerë. Norwich City kishte paguar 11 milionë euro për transferimin e Rashicës në verën e vitit 2021 nga Werder Bremen.



Ademi në drekë pune me kryetarin e UEFA-s, Aleksandër Çeferin

Prishtinë, 15 dhjetor - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, po qëndron në Katar. Ai është ftuar në drekë pune nga presidenti i UEFA-s,

Aleksandër Çeferin. Ademi dhe Çeferin biseduan me kënaqësi për futbollin, u këshilluan për planet dhe vizionin për të ardhmen. "Bashkërisht e presim finalen e

jashtëzakonshme të Kupës së Botës, ku Franca si përfaqësuese evropiane do të luajë kundër Argjentinës", ka thënë Ademi. Dy presidentët, ai i UEFA-s dhe FFK-së, ishin të

shoqëruar edhe nga drejtori i Federatave Kombëtare në UEFA, Zoran Lakoviq dhe presidenti i FShF-së, njëherësh anëtar i KE të UEFA-s, Armand Duka.



Deschamps: Jam krenar për këtë ekip, tani kërkojmë trofeun

Doha, 15 dhjetor - Didier Deschamps e ka shkruar historinë e Kupës së Botës, por tashmë ai kërkon të barazojë një rekord 84 vjeçar. "Gjenerali i Vogël" udhëhoqi Francën për të dytën herë radhazi në finale

të Kupës së Botës, duke u treguar të gjithëve se mbetet strateg dhe jo rastësisht erdhën sukseset. Megjithatë, ai nuk ndalet, tashmë kërkon trofeun e dytë si trajner, teksa si futbollist e ka ngritur vetë në vitin 1998

teksa ishte kapiteni i Gjelave. "Jam krenar për këtë ekip, sinjerisht që kam më shumë emocione se katër vjet më parë. Ne kemi një muaj që jemi bashkë me lojtarët, nuk është asnjëherë e lehtë dhe, gjithashtu, kemi

qenë edhe me fat deri tani. Por lojtarët janë shpërblyer për atë që kanë dhënë në fushën e lojës. Tani kërkojmë trofeun, do të kemi edhe një sforcio të fundit të dielën", ka thënë Deschamps.



Joshua: Koha ime po mbaron

LONDËR, 15 DHJETOR - Boksieri britanik Anthony Joshua, ish-kampion bote në peshën e rëndë, ka deklaruar se karrierës së tij po i vjen fundi. Ai e konsideron veten "plak", ndërkohë që synon të rikthehet në ring në pranverën e vitit të ardhshëm. Joshua nuk duhet të jetë prej gushtit të këtij viti, kur humbi revanshin ndaj Usyk. Britaniku u shpreh se i duhet të punojë shumë për t'i bërë vitet e fundit të karrierës së tij të këndshme dhe të suksesshme. Gjithsesi, ai pranon se mezi pret të dalë në pension dhe të ndërtojë një familje. "Jam i hutuar, jam si një plak që i ka kaluar koha në ring. Unë e shoh veten se nuk jam as në fillim e as në mes të karrierës time, por në fundin e saj", ka thënë Joshua. "Koha ka kaluar shpejt dhe dua të sigurohem që në fundin e karrierës time të arrij ato gjëra që nuk kam pasur mundësi t'i arrij



më parë. Mendoj se arritja ime më e madhe s'ka ardhur ende. Mendoj se kur të tërhiqem do të qaj, pasi i kam dhënë shumë këtij sporti, kam sakrifikuar shumë", u shpreh Joshua. "Të gjithë ne kemi ditët e këqija, por

gjithmonë jam përpjekur të jem i fortë. Mezi po pres të rikthehem në ring më i fortë", ka shtuar Joshua që pret ta mësojë emrin e rivalit të tij, që mund të jetë Deontay Wilder ose Dillian Whyte.

Golden State, një zhgënjim jashtë shtëpisë, fitojnë Miami e Denveri

INDIANAPOLIS, 15 DHJETOR - Skuadra kampione e Golden States vijon të zhgënjë jashtë fushës teksa u mund edhe me rezultat 125-119 nga Indiana. Stephen Curry ishte lider në fushë për miqtë, autor i 38 pikëve, por që s'mjaftuan për të fituar. Për Indianan u dalluan Huliburton me 29 pikë e Mathurin me 24 pikë. Denveri i afrohet kreut në Perëndim pas fitores me rezultat 141-128 ndaj Washingtonit, sfidë ku vendasit dominuan falë 43 pikëve e 14 reboundeve të Nikola Jokiqit. Fitore të vështirë korri skuadra e Miamit, që mundi në fund me rezultat 110-108 Oklahoman, me



Herro protagonist, autor i 35 pikëve. Zhgënjën edhe Chicago, që u mund me rezultat 128-120 nga New York, me dyshen Randle - Brunson protagonistë për miqtë,

që së bashku realizuan 61 pikë. Për Dallasin nuk mjaftuan 30 pikët e Luka Donqiq për ta evituar humbjen, 105-90 ndaj Cleveland (Mitchell 34 pikë për miqtë).

REZULTATET

Charlotte - Detroit	134-141
Indiana - Golden State	125-119
Orlando - Atlanta	135-124
Chicago - New York	120-128
Toronto - Sacramento	123-124
Oklahoma - Miami	108-110
San Antonio - Portland	112-128
Dallas - Cleveland	90-105
Denver - Washington	141-128
Clippers - Minnesota	99-88

Barça i dëshiron Gundoganin dhe Silvën

Skuadra e Barcelonës vazhdon të jetë e përfolur për transferimin e futbollistëve të ndryshëm pavarësisht prej problemeve financiare. Sipas

asaj që raporton "Manchester Evening News", Barcelona është duke shikuar për ta përforcuar mesfushën me dy veteranë të Manchester Cityt.

Xavi dëshiron që të ketë mesfushë me përvojë dhe këta dy futbollistë që ai dëshiron janë Ilkay Gundogan dhe Bernardo

Silva, të dy futbollistët të cilët kanë arritur në fund të kontratave të tyre me skuadrën kampione të Anglisë. Të dy futbollistët

lidhen shumë me një largim nga klubi dhe gjigantët spanjollë do të shikojnë të nënshkruajnë me ta gjatë verës së ardhshme.

SHKURT

Pas një kohë të gjatë Besa Famgas ndalet në barazim

Besa Famgas është ndalur në barazim pas një kohe të gjatë në Superligën e Kosovës në hendboll. Ndeshja Kastrioti - Besa Famgas përfundoi 31:31. Ishte ndeshje e mbetur e xhiros së 11-të e Superligës së Kosovës në hendboll.

Festim Mustafa i shënoi 14 gola për Kastriotin. Shtatë i kishte Jeton Bislimi, kurse nga tri i realizuan Shpëtim Mehmeti e Gëntit Brahimi. Arbios Mushkolaj i shënoi 12 gola për Besën. Gjashtë i kishte Olsi Mulaj, kurse nga pesë i shënuan Ivan Majiq e Ardit Tafilaj. Besa Famgas, që nuk ka lëshuar pikë për kohë të gjatë, udhëheq në tabelë me 19 pikë nga dhjetë ndeshje. Kastrioti është i katërti me 11 pikë nga 11 ndeshje.

Mick Schumacher i bashkohet Mercedesit

Piloti gjerman Mick Schumacher ka ndarë rrugët me skuadrën e Ferrarit për të kaluar te Mercedesi. Skuadra e Mercedesit ka konfirmuar marrëveshjen me Mick, pak minuta pas përhëndetjes së Ferrarit me pilotin gjerman. "Jemi të lumtur të konfirmojmë se Mick Schumacher do t'i bashkohet skuadrës në rolin e pilotit rezervist për vitin 2023", thuhet në njoftim.

Mick sezonin e kaluar ishte pjesë e Haas.

Macroni: Ky lojtar i Marokut është mesfushori më i mirë i Botërorit

Maroku u eliminua nga Kupa e Botës por, në fakt, bëri një paraqitje të jashtëzakonshme. Një nga më të mirët te marokenët ishte padyshim mesfushori Sofyan Amrabat, i cili luan me Fiorentinën në Itali dhe në këtë Kupë Bote ka rikuperuar plot 51 topa, më shumë se çdo futbollist afrikan. Amrabat ka marrë edhe komplimentet e presidentit francez Emmanuel Macron pas ndeshjes. "Ke qenë mesfushori më i mirë i këtij Botërori", i ka thënë Macroni mesfushorit maroken pas ndeshjes.

Regragu: Ne bëme më të mirën, kjo është gjëja më e rëndësishme

Maroku është eliminuar nga Kupa e Botës, pasi pësoi humbje nga Franca (2-0). Trajneri Walid Regragu është shprehur i kënaqur me paraqitjen e futbollistëve marokenë. "Ne bëme më të mirën, që është gjëja më e rëndësishme. Kishim disa lëndime, por ata që luajtën bënë maksimumin dhe ne u kthyem në lojë menjëherë pasi pësuam golin në pjesën e parë. Në pjesën e dytë shkoi edhe më mirë, ne u përpoqëm ta shënonim golin e barazimit deri në minutën e fundit, por nuk ia dolëm", ka thënë Regragu.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Eldioni" L.L.C. me pronar Hysni Maloku, Podujevë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811903435 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Eldioni" L.L.C. Hysni Maloku, Podujevo, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811903435 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Eldioni" L.L.C. Hysni Maloku, Podujev, has come to the decision to quit its business: 811903435 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

www.facebook.com/gjejpuneshepte

RESTAURANT




SWISS

TAVERNA



Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Endi Deva nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të SH.F. "Mazllom Këpuska" nga kl. I-V dhe VI-IX.

- "Gazeta Newborn" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 810748981.

- Anton Bushaj nga Novosella e Ulët KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F "Engjëll Gjoni" Novosell e Ulët KK Gjakovë nga kl. I-VIII

- Mihrem Bajra shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmt "11 Marsi" Prizren.

- Floridan Begaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhure.

- Myrvete Kurti shpalle te pavlefshme dëftesën nga klasa 1-8 te shkollës fillore Musa Hoti (Ish Meto Bajraktari).

- D.P.H " Break Time Caffè" shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 70916479.

- Albina Hoxhaj shpalle te pavlefshme dëftesën dhe diplomën e SHMLM " De Xheladin Deda".

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

